



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 83

Tiranë – E hënë, 25 maj 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Rezolutë e Kuvendit datë 14.5.2015	Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2014..... 4363
Rezolutë e Kuvendit datë 14.5.2015	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2014..... 4364
Dekret i Presidentit nr. 9089, datë 11.5.2015	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 4365
Dekret i Presidentit nr. 9093, datë 13.5.2015	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 4366
Udhëzim i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 12, datë 9.3.2015	Për llojin, përmbajtjen, formatin dhe procedurën e dhënies së dokumenteve të certifikimit në sistemin e arsimit profesional..... 4366
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 14, datë 13.5.2015	Për disa shtesa në udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 4368
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 15, datë 18.5.2015	Për përcaktimin e procedurave për dhënien e informacionit nga çdo person në përputhje me dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën tatimore..... 4369
Urdhër i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 133, datë 4.5.2015	Për delegim kompetencash..... 4370
Urdhër i ministrit të Kulturës nr. 192, datë 13.5.2015	Për licencimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv për të drejtat e autorëve në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera audiovizuale “FMAA”..... 4370
Urdhër i ministrit të Kulturës nr. 193, datë 13.5.2015	Për licencimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv të të Drejtave te Producentëve “AMP”..... 4370

Urdhër i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 229, datë 8.5.2015	Për miratimin e rregullores për mënyrën, kushtet dhe kriteret e magazinimit e të përdorimit të lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve..	4371
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 221, datë 7.5.2015	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike në qarkun Elbasan, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	4386
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 222, datë 7.5.2015	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste në qarkun Durrës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	4387
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 223, datë 7.5.2015	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike në qarkun Kukës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	4389
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 224, datë 7.5.2015	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike në qarkun Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	4390
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 225, datë 7.5.2015	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste në qarkun Fier, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	4391
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 226, datë 7.5.2015	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike në qarkun Shkodër, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	4392
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 227, datë 7.5.2015	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në qarkun Elbasan, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	4393
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 228, datë 7.5.2015	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste në qarkun Fier, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	4394
Kërkesë e ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 96/194, datë 15.5.2015	Për shpronësim me interes publik, të pasurive të paluajtshme të tipit “tokë bujqësore arë”, që preken nga ndërtimi i “HEC Ashta Shkodër”.	4395
	Vendim për shpalljen të zhdukur të shtetasit Viktor Sharko.....	4400
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Klodian Perikli Londo.....	4400
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Saimir Hasanaj.....	4400

**REZOLUTË****PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË
POPULLIT PËR VITIN 2014****Kuvendi i Shqipërisë vlerëson:**

Rolin e Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues i rëndësishëm në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe njëkohësisht rolin e tij nxitës të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend.

Rolin proaktiv të Avokatit të Popullit në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në veçanti të grupeve më të dobëta në shoqëri.

Bashkëpunimin e Avokatit të Popullit me Kuvendin e Shqipërisë, nëpërmjet përgatitjes dhe depozitimit të raporteve të veçanta në Kuvendin e Shqipërisë, përgjatë vitit 2014, duke rritur rolin monitorues të Kuvendit ndaj ekzekutivit.

Kontributin e dhënë për përmirësimin e legjislacionit vendës, mes propozimeve për shtesa dhe ndryshime në ligje, shprehjes së mendimeve dhe sugjerimeve për projektligje që ndikojnë në respektimin e të drejtave të njeriut.

Veprimtarinë e këtij institucioni, në funksion të përmirësimit dhe të arritjes së standardeve më të larta në fushën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, bazuar në parimet e paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizmit dhe pavarësisë në mbrojtje të lirive dhe të drejtave të njeriut.

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se:

1. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në ligjin, “Për Avokatin e Popullit” kanë ndikuar pozitivisht në veprimtarinë e tij dhe kanë bërë të mundur që institucioni i Avokatit të Popullit të vazhdojë të ruajë standardet më të larta në veprimtarinë e tij, duke u rivlerësuar në mars 2015 me vlerësimin e nivelit A, që tregon përputhshmërinë e institucionit me Parimet e Parisit, të miratuara në Asambleja e Kombeve të Bashkuara me rezolutën 48/134, të datës 20 dhjetor 1993.

2. Numri i ankesave të drejtuara institucionit të Avokatit të Popullit dhe të atyre të zgjidhura në favor të qytetarëve, në krahasim me dy vitet e

mëparshme, ka pësuar rënie, por numri i rasteve të shqyrtuara me iniciativë të Avokatit të Popullit është rritur.

3. Numri i rekomandimeve drejtuar administratës publike është në të njëjtat nivele si në vitin 2013, por është rritur numri i rekomandimeve të pranuar nga organet e administratës publike. Nga 368 rekomandime drejtuar administratës publike, 90 rekomandime janë pranuar plotësisht, 17 rekomandime janë refuzuar, pjesa tjetër e tyre janë në proces shqyrtimi ana e organeve të administratës publike.

4. Në funksion të konsolidimit të bashkëpunimit mes Avokatit të Popullit dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme, Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë, institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar me shkrim rastet e konstatuara me shkelje ligjore.

5. Avokati i Popullit ka përgatitur 7 raporte të veçanta për Kuvendin e Shqipërisë për çështje që kanë nevojë për t’u adresuar më mirë prej organeve shtetërore, nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor, ose përmirësimit të punës së organeve përgjegjëse për trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.

6. Avokati i Popullit ka dhënë kontributin e tij në përmirësimin e legjislacionit vendës, sipas standardeve ndërkombëtare. Avokati i Popullit, ka përgatitur gjithsej 27 rekomandime legjislative, për shtesa dhe ndryshime në ligje, akteve nënligjore të Këshillit të Ministrave, ose Ministrave përkatës.

7. Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, i ngritur pranë Avokatit të Popullit, ka kryer 115 inspektime, riinspektime, kontrole me tematikë të veçantë dhe vizita monitoruese në institucionet e sistemit të burgjeve, të policisë, spitale psikiatrike, baza ushtarake ku ka dhoma sigurie, qendra ku trajtohen shtetas të huaj, azilkërkues dhe viktimat e trafikut.

8. Hartimi i raportit vjetor ka përmbushur rekomandimet e rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë të qershorit 2014 për sa i përket metodologjinë e hartimit të tij.

Kuvendi i Shqipërisë i kërkon Avokatit të Popullit për vitin 2015:

1. Të hartojë një plan tematik për monitorimin e zbatueshmërisë së rekoman-



dimeve që u ka adresuar institucioneve, me theks të veçantë rekomandimet e pranuar nga institucionet, mënyrën sesi ato zbatohen nga institucionet përkatëse.

2. Të thellojë angazhimin e tij publik në mbrojtje të interesave të shtetasve shqiptarë, në lidhje me problematikat që këta të fundit hasin në marrëdhënie me organin e prokurorisë dhe sistemin gjyqësor, duke adresuar rastet e shkeljeve ligjore në organet kompetente, si Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Prokuroria e Përgjithshme.

3. Të vazhdojë angazhimin e tij publik në mbrojtje të interesave të shtetasve shqiptarë nga organet e qeverisjes vendore, duke synuar monitorimin e zbatimit të legjislacionit të qeverisjes vendore, për respektimin e parimit të decentralizimit, për ofrimin e shërbimeve për shtetasit në nivel vendor, kjo dhe në funksion të ndarjes së re administrative.

4. Të informojë Kuvendin e Shqipërisë në vazhdimësi, lidhur me rekomandimet e tij, për ndryshimet e nevojshme legjislative në mbrojtje të lirive dhe të drejtave të njeriut.

5. Të kontribuojë aktivisht për përmirësimin e legjislacionit vendës, në funksion të rekomandimeve të ProgresRaportit të Komisionit Evropian, ku i kërkohet Avokatit të Popullit të jetë pjesë e konsultimeve të projektligjeve në komisionet parlamentare.

6. Në kuadër të funksionit si Mekanizëm për Parandalimin e Torturës, Avokati i Popullit duhet të thellojë hetimet, mbi të cilat mbështet rekomandimet e tij, si dhe të jetë më proaktiv, në lidhje me respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria, në komisaritet e policisë dhe vendet e ekzekutimit të vendimeve penale. Të monitorojë, përmes një programi tematik, të gjitha kutitë postare të Avokatit të Popullit, që ndodhen në ambientet e institucioneve të paraburgimit dhe vuajtjes së dënimit.

7. Të forcojë bashkëpunimin mes institucioneve të tjera të pavarura dhe të specializuara në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

8. Të përmirësojë metodologjinë e hartimit dhe paraqitjes së raporteve të veçanta, duke ndërthurur tregues sasiore dhe cilësorë të punës së kryer, arritjeve dhe vështirësive të hasura dhe duke adresuar rekomandime konkrete për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut.

9. Të realizojë në kohë dhe me cilësinë e duhur procedurat e parashikuara nga ndryshimet e reja ligjore për përzgjedhjen, në përputhje me kriteret përkatëse ligjore të kandidaturave për komisionerët e rinj të zyrës së Avokatit të Popullit.

10. Në funksion të rritjes së transparencës, të publikojë çdo financim, donacion ose projekt, që përfiton nga të tretët, në portalin zyrtar të internetit. Në respekt të nenin 37, të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, Avokati i Popullit duhet të dërgojë informacion lidhur me donacionet e marra nga të tretët në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

Miraturar në datën 14.5.2015

KRYETARI
Ilir Meta

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES
FINANCIARE PËR VITIN 2014

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke njohur rolin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për mbikëqyrjen e tregjeve financiare jobankare, në Republikën e Shqipërisë,

- Duke njohur kontributin e tij në drejtim të nxitjes së qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së këtyre tregjeve,

- Duke njohur rolin e këtij Autoriteti për t'i siguruar Kuvendit, drejtuesve të institucioneve shtetërore dhe publikut në përgjithësi një informacion cilësor e profesional mbi këto tregje,

- Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë Autoritet, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e tij me institucionet kombëtare e ndërkombëtare,

Vlerëson veprimtarinë e autoritetit të mbikëqyrjes financiare në drejtim të:

- Forcimit të rolit mbikëqyrës dhe rregullator të AMF-së në përmbushje të objektivave të saj, nëpërmjet forcimit të pavarësisë, llogaridhënies dhe të përgjegjshmërisë;

- Përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit ligjor dhe nënligjor, në përputhje me parimet ndërkombëtare dhe direktivat evropiane;



- Mbrojtjes së interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, duke garantuar në të njëjtën kohë zhvillimin dhe sigurinë e operatorëve të mbikëqyrur;

- Hartimit të metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus riskun për tregun e sigurimeve dhe krijimin e platformës bazë për të bërë të mundur tarifimin me bazë riskun;

- Plotësimit të detyrimeve të shoqërive të sigurimit ndaj Byrosë për financimin e Fondit të Kompensimit për pagesat e prapambetura;

- Forcimit të bashkëpunimit me organizmat dhe institucionet, kombëtare dhe ndërkombëtare, në tërheqjen e politikave më të mira dhe asistencës teknike të nevojshme.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për vitin 2015, të angazhohet në këto drejtime:

- Të ndërmarë ndryshime strukturore dhe organizative të nevojshme për t'iu përshtatur prirjeve të zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje dhe sfidave që shtrohen për mbikëqyrjen dhe rregullimin e tyre.

- Të paraqesë, brenda muajit shtator 2015, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, amendimet ligjore për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike, si dhe të vijojë zbatimin e masave stabilizuese në tregun e sigurimeve dhe vendosjes së standardeve të mirëpërcaktuara, në lidhje me rezervat minimale, nivelin e likuiditetit, mjaftueshmërisë së kapitalit, praktikave të provigjonimit dhe sidomos përmirësimin e raportit dëme/prime.

- Të forcojë kapacitetet mbikëqyrëse, duke specializuar aftësitë në funksion të një mbikëqyrjeje efektive që i përgjigjet në kohë dhe në cilësi kompleksitetit dhe zhvillimit të tregjeve.

- Të plotësojë kuadrin rregullator për të përmirësuar administrimin e rreziqeve të fondeve të investimeve, veçanërisht rrezikut të likuiditetit, vlerësimit të aseteve të tyre, sipas praktikave ndërkombëtare, si dhe të forcojë edukimin e investitorëve në skemat e investimeve kolektive.

- Të sigurojë që kompanitë të kenë politikat e tyre të menaxhimit të rrezikut dhe veprimtaria rregulluese dhe mbikëqyrëse e Autoritetit të riformatohet për t'iu përshtatur ndryshimit të profilit të rreziqeve të tyre.

- Të hartojë politika mbështetëse për

zgjerimin e gamës së produkteve në fushën e sigurimeve vullnetare të jetës dhe të jojetës, si dhe në fushën e pensioneve vullnetare, duke rritur ndërkohë edhe vetëdijësimin e punëdhënësve dhe punëmarrësve për të përdorur produktet që ofron tregu.

- Të rrisë ndërgjegjësimin e publikut, në bashkëpunim me kompanitë e sigurimit, në lidhje me produktet e sigurimit në sektorin e bujqësisë, sidomos për sigurimin nga ndikimi i motit.

- Të vazhdojë përmirësimet për të optimizuar funksionimin e faqes zyrtare *online*.

- Të monitorojë plotësimin e detyrimeve të shoqërive të sigurimit ndaj Byrosë, për financimin e Fondit të Kompensimit dhe ndjekjen e zbatimit të vendimeve për kryerjen e pagesave të dëmeve, objekt i këtij Fondi, në kohën e duhur.

- Të monitorojë dhe të auditojë procedurat e ndjekura nga shoqëritë e sigurimit për trajtimin e dëmeve të paguara dhe atyre të mbetura pezull, kryesisht dëmet në proces gjyqësor dhe dëmet e refuzuara.

- Të inkurajojë dhe të rrisë besimin e konsumatorit në rolin e AMF-së, nëpërmjet ngritjes së një kuadri bazë për parandalimin e abuzimeve në treg, dhe rritjes së efektshmërisë së funksioneve të AMF-së.

- Të kontribuojë në rritjen e qëndrueshmërisë financiare, nëpërmjet hartimit të kuadrit të masave për administrimin e situatave problematike në sistemin financiar në vend, në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF).

Miraturar në datën 14.5.2015

KRYETARI
Ilir Meta

DEKRET

Nr. 9089, datë 11.5.2015

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,



DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Armand Nedim Kambo
2. Kleant Xhemal Demuçaj
3. Bledian Josif Çullaj
4. Suela Muhamet Thaçi (Tafaj)
5. Agila Armand Thaçi
6. Aurora Fatos Megjidi
7. Besar Irfan Mitku
8. Annette Astrit Cerma (Çerma)
9. Behar Kadri Mehmetaj
10. Hajredin Beqir Bajri
11. Manjola Prekë Volaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 9093, datë 13.5.2015

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të nenit 9, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Abdil Muareem Murtezani (Karimani)
2. Hikmet Muareem Murtezani (Karimani)
3. Hashim Rexhep Berisha
4. Arber Hashim Berisha
5. Liridona Hashim Berisha
6. Agon Hashim Berisha
7. Fatih Mehmet Mehmet Eryilmaz
8. Kasim Ahmet Çiftci
9. Alnadar (Al Nadar) MHD (Mohamad) Badri Samou Osman

10. Amir Memet Gashi
11. Murat Nusret Mamo
12. Mutlu Mustafa Mamo (Çetin)
13. Shady Mohamed Hassan Kamoun
14. Nuri Kubilay Fuat Ensari
15. Halil Battal Gazi Karimiş
16. Ayşegül Halil Ibrahim Karimiş (Buldu)
17. Azra Halil Karimiş
18. Alexandros Ioannis Dafilis
19. Armira Sefer Çelo (Seferi)
20. Maria (Marija) Sergej Rakipi (Kuzharova)
21. Hata Maliq Koca
22. Liridon Husen Trstena
23. Fatima El Arbi Noka (Ouldmou)
24. Selman Rexhep Hajzeri
25. Bahrije Imer Hajzeri (Jashari)
26. Vjosa Selman Hajzeri
27. Mirjeta Selman Hajzeri
28. Liridon Selman Hajzeri
29. Egzon Selman Hajzeri
30. Mehmet Siddik Fetullah Çelik

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 12, datë 9.3.2015

**PËR LLOJIN, PËRMBAJTJEN,
FORMATIN DHE PROCEDURËN E
DHËNIES SË DOKUMENTEVE TË
CERTIFIKIMIT NË SISTEMIN E
ARSIMIT PROFESIONAL**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 14, pika 1, të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 10, pika 1, germa “a” dhe pika 1, germa “b”, dhe të nenit 14, pika 2, germa “e”, të ligjit nr. 10247, datë 4.3.2009, “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”,

UDHËZOJMË:

1. Në përfundim të klasave X, XI dhe XII, të gjithë nxënësit pajisen me dëftesë shkollore.



2. Në përfundim të çdo niveli të arsimit profesional, nxënësit ose studentët i nënshtrohen vlerësimit përfundimtar dhe pajisen me dokument certifikimi.

3. Dokumentet e certifikimit, në përfundim të nivelit I, II dhe III, të arsimit profesional, pasqyrojnë rezultatet e arritjeve të nxënësit për programe që u përkasin respektivisht kualifikimeve profesionale të nivelit 2, 3, dhe 4 të KSHK-së.

4. Dokumentet e certifikimit, në përfundim të arsimit profesional pas të mesëm (arsimi jouniversitar) pasqyrojnë rezultatet e arritjeve të studentëve për programe që u përkasin kualifikimeve të nivelit 5 të KSHK-së.

5. Matura Shtetërore certifikohet në mënyrë të pavarur, si një kualifikim tërësisht më vetë.

6. Llojet e dokumenteve të certifikimit:

a) Dëftesa shkollore është dokumenti i lëshuar nga institucionet ofruese të arsimit profesional, ku pasqyrohen rezultatet e nxënësit në një vit shkollor;

b) Certifikata profesionale (e nivelit) është dokumenti i lëshuar nga institucionet ofruese të arsimit profesional për nxënësit, që plotësojnë/përmbushin me sukses kërkesat për një kualifikim profesional të caktuar brenda niveleve 2 - 4 të KSHK-së. Certifikata profesionale shoqërohet me dëftesën shkollore;

c) Certifikata e Maturës Shtetërore profesionale lëshohet nga institucionet ofruese të arsimit profesional për nxënësit, që përfundojnë me sukses studimet;

ç) Diploma e Maturës Shtetërore profesionale është dokumenti i lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Provimeve për nxënësit që plotësojnë/përmbushin me sukses kërkesat për një kualifikimin profesional të nivelit 4 të KSHK-së;

Diploma e Maturës Shtetërore profesionale shoqërohet me certifikatën e Maturës Shtetërore profesionale;

d) Diploma profesionale është dokumenti i lëshuar nga institucionet ofruese të arsimit profesional për nxënësit që kanë plotësuar/-përmbushur me sukses kërkesat për një kualifikimin profesional të nivelit 5 të KSHK-së.

7. Dëftesa shkollore ka këtë përmbajtje:

a) Stemën e Republikës;

b) Emërtimin e ministrisë përgjegjëse për

çështjet sociale dhe emërtimin e ministrisë përgjegjëse për çështjet e arsimit;

c) Emrin identifikues të institucionit ofrues të arsimit profesional;

ç) Emërtimi i njësisë vendore arsimore;

d) Të dhënat personale (emri, atësia, mbiemri, data, vendi i lindjes) dhe numrin e amzës së nxënësit;

dh) Emërtimin e drejtimit/profilit përkatës;

e) Vitin shkollor, në përfundim të të cilit lëshohet dëftesa shkollore;

ë) Rezultatet e arritjeve të nxënësit (notat);

f) Datën e lëshimit të dëftesës;

g) Emrin dhe pozicionin e personave të autorizuar për nënshkrim;

gj) Vulat e institucionit ofrues të arsimit profesional dhe të njësisë vendore arsimore.

8. Certifikata profesionale (e nivelit) ka këtë përmbajtje:

a) Stemën e Republikës;

b) Emërtimin e ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale;

c) Emrin identifikues të institucionit ofrues të arsimit profesional;

ç) Njësia bazë e qeverisjes vendore (bashkia);

d) Të dhënat personale (emri, atësia, mbiemri, data dhe vendi i lindjes) dhe numrin e amzës të personit që përfton certifikatën;

dh) Emërtimi i drejtimit/profilit përkatës;

e) Të dhënat për nivelin e certifikatës dhe nivelin korrespondues në KSHK;

ë) Vitin shkollor, në përfundim të të cilit përfitohet kualifikimi profesional përkatës;

f) Datën e lëshimit të certifikatës;

g) Emrin dhe pozicionin e personit të autorizuar për nënshkrim;

gj) Vulën e institucionit;

h) Lista e kompetencave profesionale (sipas nivelit dhe drejtimit/profilit përkatës).

9. Certifikata e Maturës Shtetërore profesionale ka këtë përmbajtje:

a) Stemën e Republikës;

b) Emërtimin e ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale dhe emërtimin e ministrisë përgjegjëse për çështjet e arsimit;

c) Emrin identifikues të institucionit ofrues të arsimit profesional;

ç) Njësia bazë e qeverisjes vendore (bashkia);

d) Numrin e amzës të personit që përfton certifikatën dhe ID-në e maturës shtetërore;



- e) Të dhënat personale (emri, atësia, mbiemri, data dhe vendi i lindjes);
 - ë) Emërtimi i drejtimit/profilin përkatës;
 - f) Pikët mesatare për kredit;
 - g) Vlerësimet për provimet e detyruara të Maturës Shtetërore profesionale;
 - gj) Vlerësimet për provimet me zgjedhje të Maturës Shtetërore profesionale;
 - h) Vlerësimet e katër viteve shkollore;
 - i) Datën e lëshimit të certifikatës;
 - j) Emrin dhe pozicionin e personit të autorizuar për nënshkrim;
 - k) Vulën e institucionit dhe të DAR/ZA-së.
10. Diploma e Maturës Shtetërore profesionale ka këtë përmbajtje:
- a) Stemën e Republikës;
 - b) Emërtimin e ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale dhe emërtimin e ministrisë përgjegjëse për çështjet e arsimit;
 - c) Emërtimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve;
 - ç) Vitin shkollor, në përfundim të të cilit lëshohet diploma;
 - d) Emrin identifikues të institucionit ofrues të arsimit profesional;
 - dh) Njësia bazë e qeverisjes vendore (bashkia);
 - e) Emërtimi i drejtimit/profilin përkatës;
 - ë) Të dhënat personale (emri, atësia, mbiemri, data dhe vendi i lindjes) dhe ID-ja e maturës;
 - f) Datën dhe vendin e lëshimit të diplomës;
 - g) Emrin dhe pozicionin e personave të autorizuar për nënshkrim;
 - gj) Vulën e AKP-së dhe të DAR/ZA-së.
11. Diploma profesionale ka këtë përmbajtje:
- a) Stemën e Republikës;
 - b) Emërtimin e ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale dhe ministrisë përgjegjëse për çështjet e arsimit;
 - c) Emrin dhe kodin identifikues të institucionit ofrues që lëshon diplomën;
 - ç) Emërtimin e njësisë administrative;
 - d) Emrin dhe kodin identifikues të personit që përfton diplomën;
 - dh) Emërtimin e kualifikimit profesional përkatës;
 - e) Të dhëna për nivelin e diplomës dhe nivelin korrespondues në KSHK;
 - ë) Datën e lëshimit të diplomës;
 - f) Emrin dhe pozicionin e personit të autorizuar për nënshkrim;

g) Vulën e institucionit.

12. Format i dokumenteve të certifikimit përgatitet nga AKAFPK-ja dhe miratohet me urdhër të posaçëm të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

13. Format i diplomës së Maturës Shtetërore profesionale përgatitet nga AKP-ja dhe miratohet me urdhër të posaçëm të ministrit përgjegjës për çështjet e arsimit dhe ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

14. Dokumentet e certifikimit i dorëzohen vetëm personit në emër të të cilit janë lëshuar apo një personi tjetër të autorizuar dhe pajisur me prokurë.

15. Kopjet e dokumenteve të certifikimit me fotografi arkivohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Erion Veliaj

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

UDHËZIM Nr. 14, datë 13.5.2015

PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 24, DATË 2.9.2008, “PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 10, pika 1, dhe nenit 50, pika 4, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Pas pikës 49.3, shtohet pika 49.4, me përmbajtjen e mëposhtme:

“49.4 Në rastin e shitjes së dekoderave, në faturën tatimore, shkruhet numri personal i identifikimit të individit blerës të dekoderit. Numri



personal i identifikimit të blerësit, person i patatueshëm, vendoset në vendin e përcaktuar në faturë, për vendosjen e NIUS-it, për rastet kur blerës është një person i tatueshëm.”

2. Pas pikës 50.9, shtohet pika 50.10, me përmbajtjen e mëposhtme:

“50.10 Në rastin e shitjes së dekodereve, në faturën tatimore me TVSH, shkruhet numri personal i identifikimit të individit blerës të dekodërit. Numri personal i identifikimit të blerësit, person i patatueshëm, vendoset në vendin e përcaktuar në faturë, për vendosjen e NIUS-it, për rastet kur blerës është një person i tatueshëm.”

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
SHKËLQIM CANI

UDHËZIM

Nr. 15, datë 18.5.2015

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT NGA ÇDO PERSON NË PËRPUTHJE ME DISPOZITAT E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN TATIMORE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 61/1, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Financave

UDHËZON:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), për qëllime të zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare për çështjet tatimore dhe në zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat parashikojnë asistencë administrative në çështjet tatimore dhe janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, kërkon informacion ndaj/dhe për çdo person, përfshirë, por pa u kufizuar, në informacionin e mbajtur nga banka dhe institucione të tjera financiare.

2. Çdo person, me kërkesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në përputhje me dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën tatimore, jep informacionin e kërkuar

sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.

3. Për informacionin e dhënë, në zbatim të këtij udhëzimi, zbatohen të njëjtat rregulla si për informacionin e dhënë për qëllime të zbatimit të legjislacionit vendës, përveç kur në marrëveshjet ndërkombëtare është parashikuar ndryshe.

4. Në rast të paraqitjes së një kërkesë në zbatim të dispozitave të marrëveshjeve ndërkombëtare në fuqi, nga një autoritet tatimor i një shteti tjetër me të cilin ka një marrëveshje ndërkombëtare, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, brenda 7 ditëve nga data e marrjes së kërkesës nga autoriteti i huaj, i drejton një kërkesë me shkrim personit, i cili disponon informacionin e kërkuar. Në kërkesë specifikohen të dhënat identifikuese të tatimpaguesit për të cilin kërkohet informacioni për qëllime tatimore, periudha dhe arsyeja e kërkesës së këtij informacioni.

5. Në kërkesën e paraqitur ndaj personit, sipas përcaktimeve të pikës 4, specifikohen dhe penalitetet që aplikohen sipas dispozitave të nenit 126, “Mosdhënie e informacionit”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në rastet e mosdhënies së informacionit nga ky person.

6. Personi ndaj të cilit kërkohet informacioni, brenda 30 ditëve nga data që kërkesa është marrë ose vlerësohet të jetë marrë, paraqet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në formë shkresore, informacionin e kërkuar.

7. Në rast të mosdhënies së informacionit brenda afateve të përcaktuara, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve merr masat për aplikimin e penaliteteve, sipas nenit 126 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

8. Me marrjen e informacionit të kërkuar, sipas pikës 4 të këtij udhëzimi, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, brenda 7 ditëve, i kthen përgjigje autoritetit tjetër tatimor. Në çdo rast, përgjigja, përveç informacionit të kërkuar, përmban edhe kërkesën ndaj autoritetit tjetër tatimor mbi zbatimin e detyrimit për përdorimin konfidencial dhe ruajtjen e sekretit të këtyre informacioneve, njëloj siç veprohet me informacionet e brendshme, në përputhje me dispozitat e legjislacionit të brendshëm dhe me dispozitat e marrëveshjes tatimore, si dhe përdorimin e këtij informacioni vetëm për qëllime tatimore.



Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

URDHËR
Nr. 133, datë 4.5.2015

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Sekretarit të Përgjithshëm të këtij institucioni znj. Itena Ndroqi.

2. Kompetencat e titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, do të ushtrohen për periudhën nga data 1.5.2015 deri më 1.9.2015.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQËNIES SOCIALE
DHE RINISË
Erion Veliaj

URDHËR
Nr. 192, datë 13.5.2015

**PËR LICENCIMIN E AGJENCISË SË
ADMINISTRIMIT KOLEKTIV PËR TË
DREJTAT E AUTORËVE NË FUSHËN E
KINEMATOGRAFISË DHE TË
VEPRAVE TË TJERA AUDIOVIZUALE
“FMAA”**

Duke marrë parasysh propozimin nr. 446 prot., datë 4.5.2015, të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit, për licencimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv për të drejtat e autorëve në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera audiovizuale “FMAA”,

KONSTATOVA:

Se, në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 9380, datë 28.4.2005, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, i ndryshuar, është kompetencë e ministrit të Kulturës, miratimi i dhënies së licencës kësaj Agjencie në fushën e menaxhimit kolektiv të të drejtave të autorëve në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera audiovizuale “FMAA”.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 1, të nenit 108 dhe pikave 1 dhe 3, të nenit 109, të ligjit nr. 9380, datë 28.4.2005, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Licencimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv për të drejtat e autorëve në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera audiovizuale “FMAA”.

2. Afati i licencës është 3 (tre) vjet nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I KULTURËS
Mirela Kumbaro Furxhi

URDHËR
Nr. 193, datë 13.5.2015

**PËR LICENCIMIN E AGJENCISË SË
ADMINISTRIMIT KOLEKTIV TË TË
DREJTAVE TE PRODUCENTËVE
“AMP”**

Duke marrë parasysh propozimin nr. 445 prot., datë 4.5.2015, të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit, për licencimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv të të Drejtave te Producentëve “AMP”,

KONSTATOVA:

Se, në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 9380, datë 28.4.2005, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, i ndryshuar, është kompetencë e ministrit të Kulturës, miratimi i dhënies së licencës, kësaj Agjencie, në fushën e menaxhimit kolektiv të të drejtave të producentëve “AMP”.



Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 1, të nenit 108 dhe pikave 1 dhe 3, të nenit 109, të ligjit nr. 9380, datë 28.4.2005, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Licencimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Producentëve “AMP”.

2. Afati i licencës është 3 (tre) vjet nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I KULTURËS
Mirela Kumbaro Furxhi

URDHËR

Nr. 229, datë 8.5.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MËNYRËN, KUSHTET DHE KRITERET E MAGAZINIMIT E TË PËRDORIMIT TË LËNDËVE PIROTEKNIKE E FISHEKZJARRËVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7/1, pika 3, të ligjit 9126, datë 29.7.2003, “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore, “Për mënyrën, kushtet dhe kriteret e magazinimit e të përdorimit të lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Policia e Shtetit dhe Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe e Shpëtimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

RREGULLORE

PËR MËNYRËN, KUSHTET E MAGAZINIMIT E TË PËRDORIMIT TË LËNDËVE PIROTEKNIKE E FISHEKZJARRËVE

KREU I

OBJEKTI, QËLLIMI, PËRKUFIZIME, BAZA LIGJORE, FUSHA E ZBATIMIT

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve, kriterëve dhe mënyrës së magazinimit e të përdorimit të lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve, në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të unifikojë dhe të standardizojë veprimtarinë e strukturave të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe PMNZSH-së në qark, për kontrollin, verifikimin dhe zbatimin e rregullave të magazinimit dhe të përdorimit të lëndëve piroteknike fishekzjarrë, si dhe mënyrën, kushtet dhe kriteret e magazinimit dhe të përdorimit të tyre nga subjektet e licencuara në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3

Përkufizime

Lëndët piroteknike dhe fishekzjarrë që lejohen të importohen, eksportohen apo prodhohen në Republikën e Shqipërisë, janë ato mallra, transformimi i të cilave bëhet vetëm me djegie, me shpejtësi 1-10 m/sek, të cilat lëshojnë flakë dhe dritë, me ndriçim, me ngjyra të ndryshme dhe që përcaktohen në pjesën II, klasa I, grupet 3 e 4, me kod klasifikimi 1.3G ose 1AG, siç parashikohet në marrëveshjen evropiane për transportin rrugor ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme (ADR), ratifikuar me ligjin nr. 9272, datë 16.9.2004, “Për transportin e lëndëve të rrezikshme”.

1. “Sigurim” është tërësia e rregullave dhe e masave me karakter teknik për shmangien e rreziqeve, që vijnë nga magazinimi i lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrë.

2. “Vlerësim konformiteti” janë veprimet për përcaktimin dhe plotësimin e kërkesave teknike,



të vendosura në ligj, për magazinimin e lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrë.

3. “Siguria publike” në kuptim të kësaj rregullore dhe rregullores për sigurimin teknik të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë janë zbatimi i rregullave gjatë magazinimit e përdorimit të lëndëve piroteknike fishekzjarrë.

4. “Regjistrim” është sistemi ku hidhen të dhënat, hyrjet e daljet nga magazina e lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrë, si dhe lëvizjet (shitblerjet) brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, deri tek identifikimi i përdoruesit të fundit.

5. “Magazinimi” është vendosja, administrimi i lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrë, sipas përcaktimeve në këtë rregullore dhe në rregulloren për sigurimin teknik të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë, në mënyrë që të mos cenohet sigurinë për jetën dhe shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe pronës.

6. “ADR” është marrëveshja evropiane për transportin rrugor ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme, ratifikuar me ligjin nr. 9272, datë 16.9.2004, “Për transportin e lëndëve të rrezikshme”.

7. “Shitja” është procesi i tregtimit të fishekzjarrëve nga subjekti i licencuar për tregti, për shitjen e fishekzjarrëve.

8. “Përdorimi i fishekzjarrëve” është veprimi me fishekzjarrë.

9. “Shënimi CE” është shenjë e detyrueshme e përputhshmërisë në shumë produkte në tregun e vetëm në Zonën Ekonomike Evropiane - ZEE.

10. “Licencë” është akti i lëshuar nga organi kompetent, me të cilën mbajtësi i tij autorizohet të angazhohet në një lloj të veçantë biznesi apo të kryejë një aktivitet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në licencë.

Neni 4

Baza ligjore

Hartimi i rregullores, “Për mënyrën, kushtet dhe kriteret e magazinimit e të përdorimit të lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve”, mbështetet në:

1. Ligjin nr. 9126, datë 29.7.2003, “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Marrëveshjen evropiane për transportin

rrugor ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme (ADR), ratifikuar me ligjin nr. 9272, datë 16.9.2004, “Për transportin e lëndëve të rrezikshme”.

Neni 5

Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet nga të gjithë personat fizikë dhe juridikë, që magazinojnë dhe përdorin lëndë piroteknike fishekzjarrë.

2. Kjo rregullore nuk zbatohet për lëndët piroteknike fishekzjarrë, që përdoren nga Forcat e Armatosura dhe ato nën juridiksionin e Ministrisë së Mbrojtjes, përdorimi i të cilave rregullohet me ligj të veçantë.

KREU II

AUTORITETET

Neni 6

Kompetencat dhe përgjegjësitë

Ministria e Punëve të Brendshme kontrollon, verifikon, ndjek zbatimin e rregullave të magazinimit e të përdorimit të lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve, si dhe përcakton mënyrën, kushtet dhe kriteret e magazinimit e të përdorimit të tyre, pajis subjektet me autorizim për magazinim dhe përdorim të lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve.

1. Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse, për:

1.1 mbajtjen e të dhënave të subjekteve të licencuara për import-eksport të lëndëve piroteknike e fishekzjarrë për përdorim civil;

1.2 hartimin e kriterëve dhe procedurave për magazinimin dhe përdorimin e lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve;

1.3 kontrollin e evidencave për lëndët piroteknike dhe fishekzjarrë për përdorim civil, të subjekteve të licencuara.

Neni 7

Autoriteti i përgjithshëm i inspektimit

1. Inspektimi për zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje, bëhet nga Policia e Shtetit dhe Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe e Shpëtimit.

2. Strukturat, sipas pikës 1 të këtij neni, kanë të drejtë kontrolli, si dhe dhënien e masave administrative, sipas nenit 34 të kësaj rregulloreje.



KREU III PERSONAT E AUTORIZUAR

Neni 8

Kritere të përgjithshme

1. Ministria e Mbrojtjes pajis subjektin me licencë për prodhimin, importimin, eksportimin e lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve, pasi të jetë pajisur me vërtetim besueshmërie të lëshuar nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.

2. Subjekti që kërkon të pajiset me licencë për prodhimin, importimin, eksportimin e lëndëve piroteknike duhet të plotësojë këto kritere:

2.1 të mos ketë qenë i dënuar më parë me vendim të formës së prerë për vepra penale të kryera me dashje;

2.2 të mos ketë qenë apo të jetë i evidentuar për raste të kundërshtimit me dhunë ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit, nëpunësit publik ose për veprat penale të dhunës në familje, për çështje me objekt të hakmarrjes ose gjakmarrjes;

2.3 të jetë i aftë nga ana fizike dhe mendore;

2.4 të gëzojë besueshmëri sipas ligjit.

3. Verifikimi i kriterëve të lartpërmendura bëhet nga njësia përgjegjëse ku subjekti zhvillon aktivitetin, në përputhje me legjislacionin në fuqi për fushat përkatëse, sipas këtij dokumentacioni:

3.1 letërnjoftim të personit që kërkon të ushtrojë veprimtarinë me lëndë plasëse për përdorim civil;

3.2 raport mjekësor ku të vërtetohet gjendja fizike dhe psikike;

3.3 certifikatë të gjendjes gjyqësore;

3.4 vërtetim besueshmërie të shtetasit;

3.5 dy fotografi 6 x 4 cm;

3.6 për shtetasit e huaj: vërtetimin e gjendjes gjyqësore (me Apostille apo ekuivalent) nga vendet në të cilat ka pasur vendbanimin apo vendqëndrimin në 10 vitet e fundit (vetëm në origjinal).

4. Të interesuarve u kthehet përgjigjja me shkrim nëse i plotëson ose jo kriteret ligjore brenda 15 ditëve dhe dokumenti i vërtetimbësueshmërisë mbahet në dosjen e subjektit.

Neni 9

E drejta e magazinimit të lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve

1. Magazinimi dhe përdorimi i lëndëve piroteknike fishekzjarrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, mund të bëhet, në mënyrë të ligjshme, vetëm nga subjektet e pajisura me licencë, nga Ministria e Mbrojtjes për prodhimin, importin, eksportin e lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve.

2. Përpara pajisjes me licencën apo autorizimin e përcaktuar në pikën 1, të nenit 9, subjekti duhet të pajiset me autorizimin për miratimin e depos për magazinimin të lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve.

3. Për pajisjen me autorizimin për miratimin e depos për magazinimin e lëndëve piroteknike e fishekzjarrë, kërkuesi duhet të plotësojë këto kritere:

3.1 të jetë subjekt tregtar i regjistruar në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit në fuqi;

3.2 të ketë ambientin depo në pronësi apo në përdorim;

3.3 ambienti i depos të jetë i përcaktuar me destinacionin për magazinimin të lëndëve piroteknike fishekzjarrë apo në rastet kur ambienti është i adaptuar, të ketë projektin teknik të magazinës së lëndëve piroteknike fishekzjarrë të miratuar nga Reparti i Inspektim-Shpëtim-Minierave (RISHM);

3.4 ambienti i caktuar për depo, duhet të plotësojë kushtet për magazinimin e lëndëve piroteknike fishekzjarrë, sipas përcaktimeve në rregulloren e teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë dhe rregullores së ministrit të Punëve të Brendshme (rrethimi, ndriçimi, mjetet mbrojtëse nga zjarri, siguria e dyerve dhe e dritareve, vendroja për ruajtjen e depos, mjetet dhe tabelat sinjalizuese, sigurimi nga shkarkimet atmosferike).

4. Kërkesa për miratimin e depos për magazinimin e lëndëve piroteknike fishekzjarrë shqyrtohet nga komisioni i policisë që ka juridiksionin mbi territorin ku ndodhet depoja.

5. Kërkesa për miratimin e depos për magazinimin e lëndëve piroteknike fishekzjarrë, përveç të dhënave për identifikimin e kërkuesit, duhet, gjithashtu, të përcaktojë këto të dhëna:

5.1 vendndodhjen e saktë depos;



5.2 llojin e lëndës (piroteknike fishekzjarrë) për të cilën kërkohet miratimi;

5.3 kapacitetin maksimal mbajtës të depos për të cilën kërkohet autorizimi;

5.4 kohëzgjatjen e përdorimit të depos si ambient për magazinimin e lëndëve piroteknike fishekzjarrë.

6. Kërkuesi duhet të paraqesë këto dokumente:

6.1 ekstraktin e gjendjes aktuale lëshuar nga Qendra Kombëtare të Regjistrimit, sipas legjislacionit në fuqi;

6.2 dokumentin e pronësisë (certifikata apo ekuivalenti), nëse është pronë e subjektit kërkues në origjinal apo dokumenti i pronësisë dhe dokumenti që vërteton të drejtën e përdorimit, nëse është në pronësi të një të treti;

6.3 nëse ambienti është i adaptuar, vërtetim nga RISHM-ja, që përcakton se objekti i plotëson kushtet për magazinimin e lëndëve piroteknike fishekzjarrë, sipas përcaktimeve në rregulloren e teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë dhe të rregullores së ministrit të Punëve të Brendshme;

6.4 aktin teknik nga Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe e Shpëtimit;

6.5 autorizim nga agjencia rajonale për mbrojtjen e mjedisit.

7. Afati i shqyrtimit të kërkesës për miratim/mosmiratim të depos është 25 ditë.

8. Autorizimi për miratimin e depos për magazinimin e lëndëve plasëse për përdorim civil përcakton:

8.1 të dhënat e identifikimit të subjektit;

8.2 vendndodhjen e saktë të depos së miratuar;

8.3 afatin e vlefshmërisë së depos;

8.4 llojin e lëndës piroteknike fishekzjarrë për përdorim civil, për të cilën miratohet depoja;

8.5 kapacitetin maksimal të lejuar të magazinimit;

8.6 numrin e vendrojave për ruajtjen e depos.

Neni 10

Përgjegjësitë e subjekteve të licencuara

1. Subjekti i licencuar, brenda kompetencave dhe përgjegjësi të përcaktuara, siguron magazinimin dhe përdorimin e lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve, bazuar në:

Faqe| 4374

1.1 ligjin nr. 9126, datë 29.7.2003, “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

1.2 rregulloren miratuar me urdhër të ministrit të Punëve të Brendshme, “Për mënyrën, kushtet dhe kriteret e magazinimit e përdorimit të lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve”;

1.3 rregulloren për sigurimin teknik për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë.

2. Subjekti i licencuar është i detyruar të informojë, sa herë që i kërkohet nga agjencitë e zbatimit të ligjit, “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, respektivisht sipas fushave që mbulojnë.

KREU IV

ARTIKUJT E LEJUAR DHE TË NDALUAR

Neni 11

Lëndët piroteknike dhe fishekzjarrët e lejuar dhe të ndaluar

1. Lëndë piroteknike dhe fishekzjarrë të lejuara për publikun e gjerë:

1.1 fishekzjarrë të kategorisë 1 për përdorim në ambiente të mbyllura;

1.2 fishekzjarrë të kategorisë 2 për përdorim në mjedise të hapura (jashtë ndërtesave), përdoren në një distancë nga 5 deri në 8 metër nga njerëzit dhe objektet;

1.3 fishekzjarrë të kategorisë 3, prodhim pas vitit 2011. Përdoren në mjedise të hapura në një distancë mbi 25 metër nga njerëzit dhe objektet.

2. Lëndë piroteknike të kategorisë T 1 dhe P 1 për përdorim profesional:

2.1 fishekzjarrë të kategorisë 3, prodhim para vitit 2011;

2.2 fishekzjarrë të kategorisë 4;

2.3 lëndë piroteknike të kategorisë T 2 dhe P 2;

2.4 lëndët piroteknike dhe fishekzjarrët do të lejohen të përdoren për publikun e gjerë, nëse plotësojnë të gjitha standardet e BE-së, bazuar në skemën e klasifikimit për transportimin e mallrave të rrezikshme, sipas numrit serial të Kombeve të Bashkuara, kodit të rrezikshmërisë dhe grupit të përputhshmërisë;

2.5 fishekzjarrët e lejuara të BE-së janë sipas listës së mëposhtme:

(Emërtimi është vendosur sipas versionit origjinal.)



Nr.	Emërtimi	Nr.	Emërtimi	Nr.	Emërtimi
1	Aerial Wheel	11	Fountain	21	Roman candle
2	Banger	12	Ground spinner	22	Shell
3	Battery	13	Jumping cracker	23	Snap
4	Bengal flame	14	Lancework	24	Sparkler
5	Bengal match or stick	15	Mine	25	Spinner
6	Crackling granules	16	Novelty matches	26	Table bomb
7	Double banger	17	Party popper	27	Throëdoën
8	Flash banger	18	Percussion cap	28	Ëaterfall
9	Flash pellets	19	Quick match	29	Wheel
10	Flying squib	20	Rocket	30	Whistler

3. Lëndë piroteknike dhe fishekzjarrë të ndaluara:

3.1 të gjitha lëndët piroteknike dhe fishekzjarrët në kundërshtim me standardet e BE-së;

3.2 nëse përbërja apo cilësia e një produkti nuk përputhet me etiketën;

3.3 substancat piroteknike të cilat përmbajnë squfur, fosfor të përzier me klorat potasiumi, klorate të tjera apo që përmban njërën nga përzierjet e tilla;

3.4 lëndët piroteknike dhe fishekzjarrë të destinuar për përdorim profesional nga subjekti i licencuar;

3.5 produktet të cilat nuk janë në listën e produkteve të lejuara të BE-së;

3.6 lëndë piroteknike dhe fishekzjarrë të paetiketuara dhe pa udhëzimet përkatëse;

3.7 lëndë piroteknike dhe fishekzjarrë të prodhimit artizanale.

Neni 12

Përfashtimet

Përfashtimet kanë të bëjnë me:

1. Aktivitetet e lejuara me lëndë piroteknike dhe fishekzjarrë nga Forcat e Armatosura;

2. Përdorimi i lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve për qëllime eksperimentale (në bashkëpunim me subjektet e licencuara në këtë fushë);

3. Përgatitja, montimi dhe aktivizimi i lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve për krijimin e efekteve speciale teatrale, televizive apo filmike (në bashkëpunim me subjektet e licencuara në këtë fushë).

KREU V

PËRDORIMI DHE TREGTIMI I LËNDËVE PIROTEKNIKE E FISHEKZJARRËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Neni 13

Kritere të përgjithshme

1. Subjekti që furnizon me fishekzjarrë tregtarët, me qëllim përdorimi dhe shitjeje, duhet të plotësojë këto kritere:

1.1 fishekzjarrët të jenë sipas listës shtetërore të përcaktuara në nenin 11;

1.2 fishekzjarrët të kenë shënimin CE në çdo pako apo koli fishekzjarrë;

1.3 fishekzjarrët të kenë klasifikimin e KB-së për rrezikshmëri;

1.4 fishekzjarrët të kenë emrin dhe adresën e prodhuesit;

1.5 fishekzjarrët të kenë vendin dhe vitin e prodhimit;

1.6 fishekzjarrët të kenë emrin dhe llojin e produktit;

1.7 fishekzjarrët të kenë moshën minimale për blerjen dhe përdorimin e tyre;

1.8 fishekzjarrët të kenë distancën minimale të sigurisë;

1.9 fishekzjarrët të kenë këshillat e sigurisë;

1.10 udhëzuesi i përdorimit dhe këshillat e sigurisë të fishekzjarrëve të jenë në gjuhën shqipe.

KREU VI

SHITJA E FISHEKZJARRËVE

Neni 14

Shitja e fishekzjarrëve

1. Shitja me shumicë e fishekzjarrëve bëhet vetëm nga personat e licencuar dhe autorizuar nëse plotësojnë kushtet e parashikuara në këtë rregullore.



2. Shitja me pakicë e fishekzjarrëve bëhet nga persona fizikë, të cilët duhet të përmbushin kriteret e përgjithshme teknike dhe të sigurisë, që përcaktohen në ligjin, “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, i ndryshuar, si dhe në këtë rregullore.

3. Fishekzjarrët duhet të kategorizohen nga prodhuesi sipas llojit të përdorimit apo qëllimit dhe nivelit të rrezikut, duke përfshirë nivelin e zhurmës:

3.1 fishekzjarrët e kategorisë 1 që paraqesin rrezik shumë të ulët dhe nivel të zërit të papërfillshëm, të cilët kanë për qëllim të përdoren në vende të izoluara, duke përfshirë fishekzjarrë që përdoren brenda vendbanimeve;

3.2 fishekzjarrët e kategorisë 2 që paraqesin rrezik të ulët dhe nivel të ulët të zërit dhe që kanë për qëllim të përdoren në vende të hapura dhe të izoluara;

3.3 fishekzjarrët e kategorisë 3 që paraqesin rrezik të mesëm, të cilët kanë për qëllim të përdoren në vende të hapura, që kanë nivel të zhurmës e cila nuk dëmton shëndetin e njeriut;

3.4 fishekzjarrët e kategorisë 4 që paraqesin rrezik të lartë dhe kanë për qëllim të përdoren vetëm nga personat fizikë dhe juridikë të licencuar. Njihen si fishekzjarrë për përdorim profesional, të cilët kanë nivel të zhurmës që nuk e dëmton shëndetin e njeriut.

4. Substancat/lëndët piroteknike teatrale ndahen si në vijim:

4.1 substancat piroteknike për përdorim në skenë, që paraqesin rrezik të ulët të kategorisë T 1;

4.2 substancat piroteknike për përdorim në skenë, që kanë për qëllim të përdoren vetëm nga persona me përgatitje të specializuara të kategorisë T 2.

5. Substancat/lëndët piroteknike të tjera ndahen si në vijim:

5.1 substancat piroteknike që nuk iu përkasin kategorive të fishekzjarrëve apo substancave piroteknike teatrale dhe që paraqesin rrezik të ulët të kategorisë P 1;

5.2 substancat piroteknike që nuk iu përkasin kategorive të fishekzjarrëve apo substancave piroteknike teatrale, të cilat kanë për qëllim të përdoren vetëm nga persona me përgatitje të specializuara të kategorisë P 2.

6. Fishekzjarrët prodhohen në lloje të ndryshme. Tipat më të përdorshme janë:

6.1 “F 1 Torta” është fishekzjarr i konstruktuar nga shumë gyp kartoni të ngjitur së bashku. Secili gyp përmban një gjuajtje, dhe këto të gjitha janë të lidhura me fitil të brendshëm. Në momentin kur torta ndizet, fitili digjet nga njëri gyp në tjetrin, duke ndezur çdo gyp me radhë. Torta me 16 gjuajtje do të ketë 16 gypa. Tortat janë të prodhuara të përdoren në tokë dhe secila gjuajtje godet jashtë gypit, lart në ajër.

6.2 “F 2 Qiri” është emër tradicional për fishekzjarrët. Në formën më të thjeshtë, është vetëm një gyp kartoni me guaskë të vendosur brenda. Fitili është i vendosur në gypin dhe ndez mbushjen, duke hedhur guaskën jashtë, lart në ajër, ku dhe pëlcet me efektin e tij. Vetë pjesa e kartonit mbetet në tokë.

6.3 “F 3 Raketa” përbëhet nga tri pjesë kryesore. Koka, zakonisht, përbëhet nga material kartoni ose plastik. Koka vendoset në fillim të “motorit” cilindrik dhe ndizet me fitil. Motori përmban lëndë ndezëse të ngurtë shtytëse dhe shërben për të rritur nxitimin e raketës. Kur motori digjet, mbushja pëlcet duke ndezur ngarkesë. Këto produkte vendosen në shkop të gjatë, të prodhuar nga material druri.

6.4 “F 4 Shatërvanët” kanë formën e vullkanit. Të gjithë shatërvanët krijojnë shkëndija nga niveli tokësor, lart në ajër në forma e ngjyra të ndryshme.

6.5 “F 5 Mina” është fishekzjarr më i fuqishëm për shkak se përbërja pëlcet menjëherë dhe përdoret nga niveli tokësor.

6.6 “F 6 Rrota” është disk kartoni ose plastik me një numër të goditësve apo shatërvanëve që u përngajnë raketave të vendosura rreth perimetrit. Secila ndizet për të shkaktuar shkëndija dhe goditje, duke e rrotulluar rrotën. Lëvizja e shpejtë zmadhon efektin.

6.7 “F 7 Sib” (kuti e vetme ndezëse) është vetëm një tortë me përmasa të mëdha me numër të madh të efekteve. Gypat e jashtëm janë të vendosur lehtë, pra kutia mbulon pjesën e majtë dhe të djathtë të vendit të ekspozuar.

6.8 “F 8” Të tjerat përfshijnë fishekzjarrë me efekte shtizë, ujëvarë etj.

6.9 “Barut” (i quajtur barut i zi) është përzierje nga squfuri, qymyr druri dhe kalium nitrati. Digjet shpejt, duke prodhuar volum të nxehtësisë së ngurtë dhe gazra që mund të



përdoren si shtytës në armë të zjarrit dhe si përbërje e piroteknikave në fishekzjarrë. Përdorimi i barutit që përdoret për armët e zjarrit, përjashtohet nga kjo rregullore dhe trajtohet në përputhje me ligjin, “Për armët”.

7. Fishekzjarrët e kategorisë 1, 2 dhe 3, të paragrafit 2, të këtij neni, bazuar në standardet e BE-së, mund t’ju shiten personave prej moshës, si në vijim:

7.1 kategoria 1: 12 (dymbëdhjetë) vjeç;

7.2 kategoria 2: 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjeç;

7.3 kategoria 3: 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç;

7.4 kategoria T 1 dhe P 1: 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç.

8. Fishekzjarrët e kategorisë 4 sipas paragrafit 2, të këtij neni, të kategorisë T 2, sipas paragrafit 3 dhe P 2, paragrafi 4, të këtij neni, lejohen që të shiten dhe të përdoren vetëm nga personat e autorizuar dhe të licencuar.

9. Furnizuesit e fishekzjarrëve mbajnë evidencat për çdo furnizim që tejkalon 50 (pesëdhjetë) kg për një periudhë jo më pak se 3 (tre) vjet.

KREU VII

MASAT E SIGURISË DHE TË RUAJTJES

Neni 15

Kriteret e përgjithshme

1. Sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, gjatë përdorimit të fishekzjarrëve, personat fizikë dhe juridikë marrin të gjitha masat për mbrojtjen e shëndetit, jetës së njerëzve, pronës dhe mjedisit etj.

2. Zotëruesi i licencës që është i përfshirë në aktivitetet e magazinimit dhe të përdorimit të fishekzjarrëve, duhet të garantojë sigurinë e personave dhe të pronës, si dhe duhet të marrë të gjitha masat e parashikuara në bazë të përcaktimeve në këtë rregullore.

3. Zotëruesi i licencës përgatit planin e masave në rast të aksidenteve apo rasteve të tjera emergjente, siç janë: shpërthimi, zjarret dhe dëmtimet e ndryshme.

4. Zotëruesi i licencës informon të gjithë personat e përfshirë në çdo aktivitet që ka të bëjë me lëndët piroteknike fishekzjarrë, lidhur me masat e sigurisë, planin për masat që do të ndërmerren, si dhe të sigurojë trajnimin e tyre për të përdorur lëndët piroteknike fishekzjarrë, si dhe për të përballuar situatat e ndryshme në

lidhje me aksidentet dhe rastet e tjera emergjente.

5. Subjekti, çdo 6 muaj, të trajnojë të gjithë punonjësit që magazinojnë dhe përdorin lëndë piroteknike e fishekzjarrë.

6. Objektet e planifikuara për magazinim duhet të jenë fizikisht dhe teknikisht të sigurta.

7. Zotëruesi i licencës për magazinim dhe përdorim të fishekzjarrëve, është i detyruar të informojë menjëherë strukturën e policisë vendore mbi llojin dhe sasinë e lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve, në rastet kur i vidhen etj.

Neni 16

Mbrojtja nga zjarri

1. Çdo subjekt, i pajisur me licencë për magazinimin e lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve, duhet të zbatojë të gjitha rregullat e mbrojtjes ndaj zjarrit.

2. Çdo subjekt, i pajisur me licencë për magazinimin e lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve, duhet të hartojë, të afishojë dhe të mirëmbajë planet dhe dokumentet me rregullat për mbrojtjen nga zjarri, si në vijim:

2.1 ndalohet pirja e duhanit në distancën 20 m nga depoja/magazina. Në vende të dukshme vendosen tabelat, “Ndalohet duhani”;

2.2 depot/magazinat e lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve pajisen me inventarët e nevojshëm të mjeteve të mbrojtjes ndaj zjarrit (hidrantë, bombola, fuçi me ujë, rërë, shkallë, kova etj.) sasia, llojet dhe mënyra e vendosjes së tyre janë të përcaktuara në rregulloren e PMNZSH-së;

2.3 në çdo depo/magazinë, të afishohen udhëzues përdorimi për personelin, për mënyrën e përdorimit të mjeteve të MNZ-së;

2.4 kur në territorin e depos bie zjarr, menjëherë njoftohen zjarrfikësit dhe organet e Policisë së Shtetit e merren masa për ta shuar atë. Kur shihet që me mjetet e përdorura është e pamundur të ndalohet përhapja e zjarrit, të gjithë personeli largohen jashtë zonës së rrezikshme;

2.5 në territorin e depos ndalohet të ndizen zjarre ose të pihet duhan, të hyjnë njerëz me shkrepëse, çakmak, cigare dhe armë zjarri apo me mjete të tjera ndezëse;

2.6 çdo depo e përhershme e lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve që ndodhet në sipërfaqe ose gjysmë të thelluar, duhet të ketë



pajisjet e mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike rrufepritëse, në përputhje me objektet e kategorisë I, sipas normave të caktuara;

2.7 për depot me kapacitet jo më shumë se 150 kg lëndë piroteknike e fishekzjarrë, ndërtimi i rrufepritëseve nuk është i domosdoshëm, për depo me kapacitet më të madh duhet të vendoset rrufepritës sipas standardeve të BE-së EN 62305;

2.8 bari duhet prerë poshtë dhe të mirëmbahet shkurt, përreth depos;

2.9 flaka dhe pajisjet që prodhojnë shkëndija nuk duhet të përdoren brenda 20 (njëzet) m nga depoja. Kur këto pajisje janë të nevojshme për rregullimin e depos, të gjitha lëndët piroteknike dhe fishekzjarrët duhen larguar;

2.10 bojërat, vajrat, benzina, si dhe materialet e tjera të ndezshme ndalohet të magazinohen së bashku me lëndët piroteknike dhe fishekzjarrët. Materialet e autorizuar për pastrim mund të përdoren në depo për mirëmbajtje, por duhet të largohen kur nuk janë në përdorim;

2.11 tabela me artikujt e ndaluar, duhet të jetë e vendosur në vend të dukshëm në hyrje të depos.

Neni 17

Mbrojtja nga shpërthimet

1. Zotëruesi i licencës për magazinimin dhe përdorimin e lëndëve piroteknike e fishekzjarrë, duhet të marrë masat e nevojshme dhe të jetë i kujdesshëm për të parandaluar incidentet në objekt.

2. Zotëruesi i licencës vendos në vend të dukshëm penaltitetet, në rast kundërvajtjeje për personat që hyjnë në mjedisin ku magazinohen lëndët piroteknike e fishekzjarrë.

Neni 18

Masat e nevojshme për magazinimin e lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve

1. Subjekti që magazinon dhe përdor lëndë piroteknike e fishekzjarrë, duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme, si më poshtë:

1.1 parandalimin e zjarreve apo shpërthimeve që mund të ndodhin;

1.2 kufizimin e nivelit të zjarrit apo të shpërthimeve, duke përfshirë masat për parandalimin e përhapjes së zjarrit dhe transferimin e shpërthimeve nga një vend në tjetrin;

1.3 mbrojtjen e personave nga efektet e zjarrit apo të eksplodimit.

2. Subjekti duhet të informojë të gjithë personat në varësi, të përfshirë në çfarëdo aktiviteti me lëndë piroteknike e fishekzjarrë, për masat e sigurisë, planin e masave, si dhe të sigurojë trajnimin për t'u përballur me aksidentet apo rastet e tjera emergjente.

3. Shfrytëzuesit e objekteve për magazinimin e lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve, duhet të marrin të gjitha masat për parandalimin e hyrjes në magazinat e fishekzjarrëve të personave të paautorizuar.

4. Në territorin e depove të magazinimit të lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve, për përdorim civil ndalohet futja e personave të paautorizuar. Rregullat e hyrjes në territorin e magazinave zbatohen sipas rregullores së përcaktuar nga subjekti i licencuar dhe SHPSF-ja, në përputhje me kërkesat e kësaj rregullore, si dhe të rregullores për sigurimin teknik të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë.

Neni 19

Kushtet që duhet të plotësojnë nga pikëpamja infrastrukturore depot/magazinat

1. Depot që do të shërbejnë për magazinimin e lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve duhet të plotësojnë këto kushte:

1.1 godinat të jenë të vendosura në zonat me dendësi popullore sa më të ulët, sa më larg shtëpive të banimit dhe të objekteve që ndizen shpejt;

1.2 territori i depos duhet të ketë sistem kullues për kullimin e ujërave, duke i dhënë pjerrësinë e nevojshme;

1.3 infrastruktura rrugore në territorin e depos të jetë sipas standardeve bashkëkohore;

1.4 godinat brenda territorit të depos duhet të vendosen në mënyrë të tillë, që të sigurohet kalimi i lirë në çdonjërin prej tyre;

1.5 distancat midis godinave përcaktohen në projekt sipas eurokodeve që të lejojnë kalim të lirë të mjeteve e punonjësve;

1.6 depot në sipërfaqe të sigurohen me rrethim të dyfishtë, zona e ndaluar ndërmjet dy rrethimeve të jetë 50 m.

Neni 20

Kushtet që duhet të plotësojë dyqani i shitjes

1. Tregtimi i lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve, zhvillohet vetëm në ato ambiente



që plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.

2. Kriteret që duhet të plotësojë dyqani i shitjes së lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve, janë:

2.2 kapacitet i mjaftueshëm;

2.3 muret të kenë konstruksion të padjeshëm;

2.4 dyshemeja të jetë me material betoni, e llogaritur që të mbajë peshë të caktuar dhe të jetë e hidroizoluar.

3. Dyqani të jetë i lokalizuar në zona me dendësi të ulët banorësh dhe/ose i vendosur në katet e para të banesave (katet e ulëta të pallateve) dhe/ose me dy hyrje (një dalje emergjence).

4. Dyert me hapje nga jashtë dhe të pajisura me skara hekuri.

5. Dyqanet duhet të jenë të kompletuar me detektorë për identifikimin e burimeve të zjarrit dhe mjete zjarrfikëse.

6. Në rast zjarri, muret dhe dyert komunikuese me ambientet e tjera publike, duhet të durojnë zjarrit të paktën për 30 minuta.

7. Të ketë dritare për të siguruar ndriçim dhe ajrimin, të siguruar me skara hekuri.

8. Ndriçimi të bëhet me sistem hermetik.

9. Ndërtesa ku zhvillohet aktiviteti të jetë e pajisur me rrufepritëse.

10. Struktura e dyqanit ku ruhet e tregtohet lënda piroteknike/fishekzjarrë duhet të jetë e ndarë në zona.

11. Pjesa e parë është ajo për publikun, dhomë e shitjeve, në të cilat zakonisht vendosen

rafte për ekspozimin e produkteve (lëndë piroteknike e fishekzjarrë), të cilat duhet të jenë bosh, vetëm kuti reklamuese për lëndët piroteknike në përmasat e produktit original.

12. Sasia e produktit fishekzjarrë të limituar në bazë të sasisë NEC të barutit që përmban produkti. Në çdo dyqan, fishekzjarrët mund të depozitohen për një kapacitet 200 kg maksimumi “material aktiv NEC”.

13. Çdo produkt fishekzjarrë duhet të ketë “etiketa” me të dhëna teknike të produktit dhe udhëzimin e përdorimit të tyre.

14. Në këtë pjesë të dyqanit vendosen, gjithashtu, banaku i shitjeve dhe arka. Po në këtë pjesë të dyqanit vendosen edhe stenda me material figurativ për llojet e produkteve fishekzjarrë, listë çmimesh, udhëzime sigurie etj.

15. Pjesa e dytë, e cila duhet të jetë dhomë më e sigurt (në aspektin e masave të sigurisë) më rezistente ndaj zjarrit, tentativave për shpërthim etj.

16. Kjo dhomë lidhet me pjesën/zonën/-dhomën e parë nëpërmjet një dore rezistente të blinduar. Në këtë dhomë vendosen kasaforta metalike/rafte me xhama rezistente, ku ruhen produktet fishekzjarrë, të cilat sa herë bëhen gati për shitje spostohen në dhomën e shitjeve (pjesa e parë) dhe i dorëzohen klientit.

17. Në dhomën e shitjeve pas banakut lejohet të futet vetëm, administratori dhe punonjësit e subjektit.

18. Në çdo njësi shitje duhet të afishohen rregullat sipas tabelës:

1. Parandalimi i zjarrit			
DUHET		NUK DUHET	
+	Të eliminohen burimet e zjarrit.	x	Mos lejo askënd të afrohet në ambientin ku ruhen fishekzjarrë me mjete ndezëse!
+	Të vendoset tabela “Ndalohet duhani” (No Smoking).	x	Mos lejo të lagen fishekzjarrët!
+	Të kufizohen hyrjet në zonën ku mbahen fishekzjarrët.	x	Mos lejo magazinimin e produkteve kimike, si Produkte kaustike, bojëra e llakëra së bashku me fishekzjarrët!
+	Të mbahen fishekzjarrët larg daljeve të shpëtimit.	x	Mos mbani fishekzjarrë pranë mbeturinave apo produkteve perokside!
+	Të ndiqen këshillat e furnizuesit për kthimin e produkteve të pashitura.	x	Mos lejo pajisje elektrike apo lidhje të pasigurta pranë fishekzjarrëve!
2. Ndalimi i përhapjes së zjarrit			
DUHET		NUK DUHET	
+	Të mbahen fishekzjarrët në kutitë e tyre të transportit.	x	Mos hidhni fishekzjarrët e boshatisur në kuti metalike!



+	Të përdoret magazinimi i sigurt dhe i paarritshëm për klientët.	x	Mos mbani fishekzjarrë pranë artikujve që marrin flakë lehtësisht dhe bëhen burim për përhapjen e zjarrit!
+	Të mbahen fishekzjarrët në kutitë e fabrikimit deri në momentin e shitjes së tyre.	x	Mos mbani të magazinuara së bashku me fishekzjarrët pajisje najloni apo substanca të tjera të djegshme!
+	Të shmangen trajtimet e fishekzjarrëve të palejuar.	x	Mos mbani në mjediset e shitjes paleta, kuti kartoni e letre!
		x	Mos lejoni parkimin e automjeteve në afërsi!
3. Mbrojtja e jetës së njerëzve në rast zjarri			
DUHET		NUK DUHET	
+	Të siguroheni që fishekzjarrët në zonën e shitjes janë në pajtim të plotë me rregullat dhe ligjet	x	Mos mbani fishekzjarrë pranë një rruge apo daljeje shpëtimi në rast zjarri
+	Të siguroheni që rrugët e daljes dhe dyert në rast zjarri të jenë të lira (hapura)	x	Mos mbani fishekzjarrë në zonën e shitjes më tepër se kapacitetet e lejuara
+	Të siguroheni që sistemi i alarmit në rast zjarri është i testuar paraprakisht dhe punon si duhet	x	Mos mbani fishekzjarrë në dyqanin tuaj më tepër se lejon leja/autorizimi
+	Të siguroheni që kontejnerët e transportit të vendosen larg njësisë së shitjes, banesave apo objekteve publike	X	Mos lejo afrimin e personave të paautorizuar te kontejnerët

Neni 21

Ambientet e domosdoshme që duhet të ketë një depo/magazinë

Në territorin e depos për magazinimin e lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve duhet të sigurohen ambiente të veçanta:

1. Ambient (godinë) i veçantë për magazinimin e lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve;

2. Ambient (godinë) i veçantë për hapjen e arkave të lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve;

3. Godina e punonjësit të shërbimit privat të sigurisë fizike që ruan objektin;

4. Ambienti për vendosjen e mjeteve kundër zjarrit (bombola, vegla pune, fuçi ose rezervuar uji etj.).

Neni 22

Kushtet që duhet të plotësojnë ambientet dhe territori i depos

1. Ambienti, ku ruhet ambalazhi i lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve dhe godina e rojeve, duhet të jenë jashtë territorit të rrethuar.

2. Godina e rojeve duhet të ndodhet në një distancë jo më larg se 50 m nga rrethimi i depove të lëndëve plasëse, kurse vendi ku ruhet ambalazhi jo më afër se 25 m.

3. Rregullorja e ruajtjes së magazinës nga subjekti SHPSF i kontraktuar dhe numri i vendrojave i miratuar nga struktura e policisë ku ndodhet magazina.

Faqe| 4380

4. Distanca ndërmjet depove të lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve me godinat dhe objektet e tjera përcaktohen në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe “Rregullores së teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”.

5. Rrethimi i depos së lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve të bëhet me tel me gjemba, me tulla ose gurë me një lartësi jo më pak se 2 m mbi tokë.

6. Kur rrethimi është në kontakt me rrugë, hyrjet e depos duhet të jenë metalike e kyçe të sigurta.

7. Në territorin rreth depos në distancë rreth 50 m nuk duhet të ketë materiale të ndezshme. Mjedisi duhet të jetë i pastër (pa gjethe pemësh, të korret bari dhe të largohen sendet që ndizen lehtë). Në të katër anët e rrethimit vendosen tabela me mbishkrime që tregojnë se ndalohej afrimi e qëndrimi pranë depos.

Neni 23

Standardet e ndërtimit të depove të magazinimit

Ndërtimi i depove për magazinimin e lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve bëhet sipas projektit teknik të hartuar nga institucionet projektuese të miratuara nga institucionet përkatëse (RISHM), në përputhje me kërkesat e “Rregullores së teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”,



miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 533, datë 8.7.2005, “Për miratimin e rregullores së teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë” dhe rregullave të miratuara nga organi kompetent i pushtetit vendor (KRT), konkretisht:

1. Dhomat për magazinimin e lëndëve piroteknike fishekzjarrë për përdorim civil ndërtohen:

1.1 me materiale që i rezistojnë zjarrit;

1.2 materiale sa më të lehta dhe pa forcë shpërthyes.

2. Çatia duhet të jetë me material kundër zjarrit (eternite, sanduiche etj.).

3. Temperatura në ambientet e brendshme (dhomat) të magazinimit dhe të ruajtjes së lëndëve piroteknike fishekzjarrë, të mos kalojë 30°C.

4. Muret e brendshme të magazinave lyhen, ndërsa dyshemeja duhet të jetë e ngritur nga toka mbi sipërfaqe jo më pak se 30 cm.

5. Magazina përreth në distancë 50-80 cm larg mureve të shtrohen me trotuar pllaka ose beton, me pjerrësi për kullimin e ujërave, shoqëruar me kanale për evitimin e lagështisë në mure.

6. Magazina duhet të pajiset me jo më pak se dy hyrje, me qëllim që të ketë mundësi për tërheqjen e materialeve në rast zjarri.

7. Me qëllim ajrosjen e magazinës, portat duhet të jenë të dyfishta brenda me rrjetë metalike jashtë me portë druri veshur me llamarinë ose qepen.

8. Dritaret e magazinave duhet të jenë të siguruar me rrjeta metalike dhe skara metalike.

9. Për të rritur sigurinë e magazinave e të depove, dyert mbyllen me kyç të sigurt dhe plumbosen/dyllosen.

10. Në tarracat e depove të lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve ndalohet të mbahen materiale/sende të ndryshme.

11. Ngjitja në tarracë duhet të jetë nga jashtë godinës, për këtë vendosen shkallë metalike.

Neni 24

Standardet e ndriçimit të depove të magazinimit

1. Depot/magazinat e lëndëve piroteknike fishekzjarrë duhet të pajisen me dy lloje ndriçimesh, ndriçimi i punës dhe ndriçimi i avarisë.

2. Për ndriçimin e punës përdoren llamba elektrike (përdorimi i llambave me hark është i ndaluar). Për ndriçimin e avarisë përdoren llamba me akumulatorë ose me bateri.

3. Depot/magazinat dhe territori i tyre përreth sigurohen me ndriçim të plotë nga të gjitha anët, në orën 16:00 të orës lokale. Rrjeti i ndriçimit elektrik jashtë dhe brenda depos duhet të ushqehet me tension deri në 220 volt, me neuter të izoluar nga toka. Instalimet elektrike të këtij ndriçimi nuk duhet të kenë lidhje me ndërtesat e depos, ato duhet të jenë jashtë territorit të saj. Linjat elektrike ajrore, të gjitha pjesët e instalimit të ndriçimit të jashtëm, ndërlihdjes dhe sinjalizimit të jenë jo më afër se 5 m nga depo/magazina.

4. Ndriçimi i brendshëm, ndriçuesit, rrjeti elektrik dhe aparatet e tjera duhet t'u përgjigjen kërkesave të ndriçimit në mjediset me rrezik zjarri të klasave përkatëse. Në të gjitha dhomat e depos/magazinës ndalohet përdorimi i llambave lëvizëse të dorës që ushqehen nga rrjeti elektrik.

5. Linja ushqyese e ndriçimit të depos duhet të jetë me kabllo të armuar dhe me gjatësi jo më të vogël se 100 m.

6. Armatura e kabllot duhet të ketë tokëzim të sigurt si në fillim të linjës, ashtu dhe në fundin e saj, pranë hyrjes në depo. Për tokëzimin e armaturës së kabllot pranë hyrjes në depo mund të përdoret konturi mbajtës nga efektet e dyta të rrufesë.

7. Rrjeti elektrik i ndriçimit mund të bëhet me kabllo të armuar ose me kordon të mbrojtur me tuba metalikë, brenda ose jashtë murit. Armatura e kabllot dhe e tubacioneve metalike duhet të lidhet me konturin e tokëzimit.

8. Të gjitha lidhjet elektrike bëhen me kuti të posaçme me filetim ose të mbyllura me saldim. Për lidhjen e kabllot përdoren mufta metalike.

9. Ndriçuesit, çelësat, kuadrot elektrike dhe kutitë shpërndarëse, që vendosen brenda për ndriçimin e depove duhet të jenë të mbyllura mirë. Mund të përdoren pajisje të tilla të zakonshme vetëm në rast se ato vendosen jashtë depove ose ndahen nga mjedisi i brendshëm me një ndarje të përgatitur me material të qëndrueshëm ndaj zjarrit (mur tulle 12 cm, xham me trashësi 5 mm dhe materiale të tjera zjarrduruese).

10. Kabllot e ndriçimit vendosen në tako të rregullta dhe kalojnë në vende ku nuk ka asnjë mundësi dëmtimi. Kabllot që varen horizontalisht duhet të kenë takot të vendosura



0.8-1 m larg njëra-tjetrës, kurse ato që varen vertikalisht, jo më larg se 2 m. Ndalohet varja e kabllave në tavanin e dhomave të lëndëve piroteknike fishekzjarrë.

11. Kabllot që kalojnë nëpër muret e jashtme të godinave të depos së lëndëve plasëse, duhet të futen në tuba.

12. Depot e përhershme të lëndëve piroteknike fishekzjarrë, sipas rregullave, pajisen me mjete sinjalizimi/alarmi, linja telefonike, të sinjalizimit, të cilat nuk duhet të futen brenda depos, por në vendrojnë ose në ndonjë vend tjetër të veçuar jo më afër se 5 m nga magazina/depo.

Neni 25

Kushtet dhe afatet e shërbimit të një depoje magazinimi

1. Nga ana ndërtimore, depot e magazinimit të lëndëve piroteknike fishekzjarrë mund të jenë:

1.1 depot e magazinimit të lëndëve plasëse/-piroteknike fishekzjarrë sipërfaqësorë janë godina që ndodhen mbi nivelin e sipërfaqes së tokës;

1.2 depot e magazinimit të lëndëve plasëse/-piroteknike fishekzjarrë gjysmë të thelluar janë godina të thelluara në tokë deri në kornizën e çatisë;

1.3 depot/magazinimit të lëndëve plasëse/-piroteknike fishekzjarrë të thelluar kur trashësia e dheut mbi to nuk i kalon 15 m;

1.4 lëndët piroteknike fishekzjarrë rekomandohen që të magazinohen në ambiente mbitokësore, me mbulesë të lehtë (çati fluturuese) dhe të ndara me argjinatura dheu ose rërë mbitokësore.

2. Në varësi të afatit të shërbimit, depot e lëndëve piroteknike fishekzjarrë, ndahen në:

2.1 Depo të përhershme, me afat shërbimi mbi 2 vjet;

2.2 Depo të përkohshme, me afat shërbimi deri në 2 vjet;

2.3 Depo, me afat shërbimi deri në 6 muaj.

Neni 26

Kapaciteti, sasi të mënyra e magazinimit në depo dhe në pikën e shitjes

1. Në projektin teknik të hartuar, në përputhje me kërkesat e “Rregullores së teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga institucionet projektuese përkatëse në RISHM

dhe nga organi kompetent i pushtetit vendor (KRT), përcaktohet kapaciteti maksimal i depos dhe i dhomave të veçanta, në varësi të llojit të lëndëve piroteknike fishekzjarrë.

2. Mënyra e sistemimit, sasi të maksimale të magazinimit të lëndëve piroteknike fishekzjarrë në një depo magazinimi bëhet si më poshtë:

2.1 Lëndët piroteknike fishekzjarrë depozitohen në godinat e magazinimit të shoqëruara me dokumentacionin e importimit ose prodhimit (*packing list*, ku ka dhe sasinë NEC të barutit çdo produkt);

2.2 Lëndët piroteknike fishekzjarrë magazinohen të ambalazuara sipas paketimit të fabrikës. Ato sistemohen sipas llojit të artikullit të grupuara në blloqe 10 cm lart nga toka. Blloqet mund të sistemohen në lartësi jo më të madhe se 2.5 m në varësi të qëndrueshmërisë së ambalazhit. Distanca midis blloqeve duhet të jetë 1 m. Distanca nga muri jo më afër se 30 cm;

2.3 Lëndët piroteknike fishekzjarrë të llojeve të ndryshme ruhen në dhoma të veçanta të ndara me mure antizjarr me trashësi 25 cm;

2.4 Në depot e lëndëve piroteknike fishekzjarrë ndalohet hyrja me këpucë me gozhdë, përdorimi i veglave të punës për hapjen e arkave prej materiali që gjatë goditjeve krijojnë shkëndija;

2.5 Për mbrojtjen dhe sigurimin e kushteve optimale të magazinës nga lagështira dhe temperaturat kërkohet të bëhet ajrosja e magazinave. Ajrosja e magazinave nuk bëhet kur koha është me lagështirë dhe me shi ose, kur temperatura është më tepër se + 30 gradë ose më pak se - 10 gradë.

3. Tipat e fishekzjarrëve dhe lëndëve piroteknike që do të magazinohen dhe ruhen në depo/magazina dhe njësi shitje do të jenë:

Kodi i transportit	Rreziku ekuivalent
1.3 G	HT 3
1.4 G	HT 4

3.1 lëndët piroteknike dhe fishekzjarrët të kategorisë 1.3 G janë substanca dhe artikuj;

3.2 djegia e të cilëve shkakton nxehtësi të konsiderueshme ndriçuese;

3.3 djegia e të cilëve prodhon shpërthime të vogla, efekte projektuese, ose të dyja;



3.4 lëndët piroteknike dhe fishekzjarrët të kategorisë 1.4 G janë substanca dhe artikuj që shkaktojnë efekte si të pikës 3.1 G, por në një shkallë më të ulët;

3.5 përkufizimi i grupit G, është: “Substancë piroteknike apo artikull që përmban substancë piroteknike, substancë eksplozive, ndriçuese, ndezëse, tymi në forma dhe përmasa të ndryshme”.

4. Sasia e lëndëve piroteknike/fishekzjarrëve të lejuar për magazinim në një depo/magazinë do të jetë në vartësi të plotësimit të parametrave të sigurisë dhe distancës së sigurisë nga objektet e banimit, rrugët, objektet sociale, linja të tensionit, të transmetimeve radiofonike e televizive dhe tipit të depove. Distanca e sigurisë e depove/magazinave të lëndëve piroteknike e fishekzjarrë do të jetë:

4.1 artikujt e kategorisë I e II, magazinohen në depo mbitokësore. Për sasi deri në 5,000 kg

NEC, distanca e sigurisë nga objektet e tjera është 10 m.

Artikujt e kategorisë III e IV, për sasi deri në 5000 kg NEC magazinohen në depo mbitokësore.

Për sasi mbi 5000 kg NEC, magazinohen në depo me ndarje me argjintura dhe ose rërë mbitokësore;

4.2 llogaritja e distancave të sigurisë të depove për artikujt e kategorisë së III e të IV, nga objektet për banesa është produkt i formulës rrënjë kubike e NEC shumëzuar me koeficientin 35. Për objekte të tjera publike koeficienti është 20.

5. Sasia e fishekzjarrëve të lejuar për magazinim në një njësi shitje, do të jetë në varësi të sipërfaqes së objektit dhe NEC (peshës neto të lëndës eksplozive). Specifikimet e magazinimit të fishekzjarrëve për njësitë e shitjes pasqyrohen në tabelën e mëposhtme.

Sipërfaqja e ambientit të shitjes (në m ²)	Sasia e fishekzjarrëve të lejuar (në kg neto)	Sipërfaqja e ambientit të shitjes në m ²	Sasia e fishekzjarrëve të lejuar (në kg neto)
deri 20	12.5	deri 250	45
deri 40	15	deri 300	50
deri 60	20	deri 350	55
deri 80	25	deri 400	60
deri 100	30	deri 450	65
deri 150	35	deri 499	70
deri 200	40	mbi 500	75

Shënim. Pesha neto e lëndës plasëse (NEC) është e barabartë me ¼ e peshës bruto për të gjitha kategoritë e fishekzjarrëve.

Neni 27

Ruajtja dhe siguri i depove/magazinave të lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve

1. Depot e lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve ruhen me punonjës të SHPSF-së me roje të armatosur.

2. Mënyra e ruajtjes përcaktohet në bazë të rregullores tip, “Mbi përcaktimin e rregullave të ruajtjes së objektit magazinë”, e hartuar nga subjekti SHPSF dhe e miratuar nga komisarati i policisë.

3. Kur bëhet riparimi i depove/magazinave të lëndëve piroteknike e fishekzjarrë, ato duhet të hiqen nga depo dhe të vendosen në ambiente të tjera ose shesh brenda territorit të depot, duke respektuar nenet 174 dhe 177, të “Rregullores së teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”.

4. Në rastet kur ka ndonjë fatkeqësi natyrore, fatkeqësi tjetër, për nevoja të ngutshme e duhet të kryhen punime me karakter shpëtimi, lejohet ruajtja e lëndëve piroteknike e fishekzjarrë në sasi të mëdha edhe në sheshe të posaçme për jo më shumë se 30 ditë. Lëndët piroteknike e fishekzjarrë duhet të vendosen në një shtresë prej dërrase të ngritur si dyshe me 20 cm nga toka dhe të mbuluara me mushama ose ndërtohet një strehë e posaçme. Largësia e nevojshme ndërmjet sheshit ku ruhet lënda piroteknike fishekzjarrë dhe ndërtesave, objekteve, rrugëve dhe hekurudhave përcaktohet në varësi të sasisë së saj dhe në përputhje me kërkesat e “Rregullores së teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”.

5. Në territorin e depove/magazinave të lëndëve piroteknike e fishekzjarrë, lejohet hyrja e



personave të autorizuar nga drejtuesit e subjektit privat ose shtetëror, Komisariati i Policisë, sipas mënyrës dhe procedurës së përcaktuar nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 28

Masat e sigurisë gjatë zhvillimit të aktiviteteve për përdorim të lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve

1. Subjekti i licencuar për përdorimin e lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve, në aktivitete masive (festa kombëtare etj.) vë në dijeni komisaratin e policisë që ka në juridiksion vendin ku do të përdoren lëndët piroteknike e fishekzjarrë, me qëllim bashkëpunimin me subjektin që organizon aktivitetin për rritjen e sigurisë së jetës dhe pronës së komunitetit.

2. Personeli i subjektit të licencuar, që përdor lëndët piroteknike, duhet të jetë i trajnuar dhe i certifikuar.

3. Personi, i cili është duke kryer veprime me lëndë piroteknike dhe fishekzjarrë, duhet të kujdeset për të shmangur rrezikun e sigurisë, shëndetit dhe pronës.

4. Mjetet që do të bëjnë transportin nga magazina për në vendin ku do të zhvillohet aktiviteti të jenë të pajisura me ADR, sipas standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 118/2012, “Për transportin e mallrave të rrezikshme”.

5. Si gjatë transportit, dhe në vendin ku do të zhvillohet aktiviteti, duhet të jenë prezentë pajisjet MNZ-së (fikës zjarri dore etj.).

6. Produktet që do të përdoren (artikujt piroteknikë) vendosen në një distancë që nuk përbën rrezik për jetën e njerëzve, dëmtimin e banesave dhe objekteve sociale, linjave të tensionit të lartë, kabinave elektrike, karburante etj.

7. Pas përfundimit të aktiviteteve, kontrollohet ambienti dhe largohen ambalazhet, mbetjet e ndryshme që mund të përbëjnë rrezik për qytetarët dhe banesat.

8. Moszbatimi i rregullave të përcaktuara në këtë rregullore konsiderohet shkelje dhe ndëshkohet sipas kërkesave të akteve ligjore e nënligjore që normojnë këtë veprimtari.

**KREU VIII
AUTORIZIMET**

Neni 29

Specifikime të përgjithshme

1. Autoriteti përgjegjës për miratimin e objekteve për magazinimin e lëndëve piroteknike fishekzjarrë, në Republikën e Shqipërisë, për personat fizikë ose juridikë, vendës ose të huaj, është komisarati i policisë vendore ku ndodhet objekti për të magazinuar lëndët piroteknike e fishekzjarrëve.

2. Subjektet që kërkojnë të pajisen me autorizim miratimi të objektit për magazinimin e lëndëve piroteknike fishekzjarrë, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë rregullore dhe në rregulloren e teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë.

3. Vërtetimi i “Besueshmërisë”, për subjektet (persona fizikë apo juridikë), hartohet nga komisarati e policisë vendore ku personi fizik apo juridik ka vendbanimin e përhershëm.

4. Personat juridikë nga vendet e huaja kanë të drejtë të aplikojnë për magazinimin e lëndëve piroteknike fishekzjarrë në Republikën e Shqipërisë, me kusht që ata të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 30

Dokumentacioni për subjektet

1. Subjektet duhet të mbajnë këto dokumente:

1.1 Autorizim për miratimin e depos/depove të magazinimit, të lëndëve piroteknike fishekzjarrë nga komisarati i policisë vendore ku ndodhet depoja;

1.2 Fotokopje të licencës për prodhim import, lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes;

1.3 Certifikatë pronësie/kontratë qiraje të depos/depove. Për objektet provizore kërkohet të plotësohet kriteri i përcaktuar në pikën 1.4;

1.4 Projektin teknik të hartuar nga institucionet projektuese përkatëse, të miratuar në repartin e inspektim-shpëtim-minierave, (RISHM) edhe në rastet kur objekti është i adaptuar, përcakton se objekti i plotëson kushtet për magazinimin e lëndëve piroteknike e fishekzjarrë në përputhje me rregulloren e sigurimit teknik për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë, si dhe të



rregullores së miratuar me urdhër të ministrit të Punëve të Brendshme;

1.5 Aktin teknik nga Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe e Shpëtimit;

1.6 Autorizim nga agjencia rajonale për mbrojtjen e mjedisit;

1.7 Kontratën e lidhur me Shërbimin e Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike, për ruajtjen e depos/depove, së bashku rregulloren për ruajtjen e depos;

1.8 Regjistri i shitjeve të lëndëve piroteknike e fishekzjarrë me të dhënat e blerësve persona fizikë apo juridikë (emër, mbiemër, datëlindje, numri personal);

1.9 Libri i magazinës ku regjistrohen hyrje-daljet e lëndëve piroteknike e fishekzjarrë;

10. Blloqet hyrje-dalje;

1.11 Formularin e prodhuesit me të dhënat teknike dhe mënyrën e përdorimit;

1.12 Evidencën për mostrat e marra ndaj subjekteve;

1.13 Evidencën për lëndët piroteknike e fishekzjarrëve me udhëzuesit për përdorim.

Neni 31

Dokumentacioni për komisaritet e policisë

1. Strukturat e policisë vendore mbajnë këto dokumente të subjekteve të licencuara për import, prodhim të lëndëve piroteknike fishekzjarrë:

1.1 Autorizim për miratimin e depos/depove të magazinimit, të lëndëve piroteknike fishekzjarrë nga komisarati i policisë vendore;

1.2 Fotokopje të licencës për import, prodhim të lëndëve piroteknike fishekzjarrë lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes;

1.3 Certifikatë pronësie/kontratë qiraje të depos/depove. Për objektet provizore kërkohet që të plotësohet kriteri i përcaktuar në pikën 1.4;

1.4 Projektin teknik të hartuar nga institucionet projektuese përkatëse, të miratuar në repartin e inspektim-shpëtimit-minierave (RISHM) edhe në rastet kur objekti është i adaptuar, përcakton se objekti i plotëson kushtet për magazinimin e lëndëve piroteknike fishekzjarrë në përputhje me rregulloren e sigurimit teknik për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë, si dhe të rregullores së miratuar me urdhër të ministrit të Punëve të Brendshme;

1.5 Aktin teknik nga Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe e Shpëtimit;

1.6 Kontratën e lidhur me Shërbimin e Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike, për ruajtjen e depos/depove, së bashku rregulloren për ruajtjen e depos;

1.7 Regjistrin me të dhënat e subjekteve të licencuara.

Neni 32

Detyrimet dhe përgjegjësitë

1. Subjektet që disponojnë autorizimin përkatës për magazinimin e lëndëve piroteknike fishekzjarrë për përdorim civil nga komisarati i policisë vendore, janë të detyruar të zbatojnë të gjitha rregullat mbi magazinimin, ruajtjen administrimin dhe përdorimin e lëndëve piroteknike fishekzjarrë.

2. Subjektet të cilat magazinonjë lëndë piroteknike fishekzjarrë, mbajnë përgjegjësi:

2.1 Për ushtrimin e kontrolleve lidhur me zbatimin e kësaj rregulloreje, “Rregullores së teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, si dhe organizimin e punës për kualifikimin e punonjësve që punojnë me lëndë piroteknike fishekzjarrë;

2.2 Për organizimin e punës dhe vendosjen e disiplinës teknike në zbatimin e rregullave të teknikës së sigurimit për magazinimin e lëndëve piroteknike fishekzjarrë;

2.3 Për zbatimin me korrektësi të kushteve teknike për magazinimin, lëvizjen, shpërndarjen dhe kryerjen e veprimeve me lëndët piroteknike fishekzjarrë;

2.4 Për lëshimin e urdhrave lidhur me organizimin dhe instruktimin e punëtorëve me rregullat e teknikës së sigurimit në veprimtarinë me lëndët piroteknike e fishekzjarrë;

2.5 Për zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje dhe rregullores teknike mbi ruajtjen e lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve brenda dhe jashtë depos;

2.6 Për mbajtjen e rregullit të dokumenteve të hyrje-daljeve të lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve;

2.7 Për mbajtjen në gatishmëri të inventarit të mjeteve kundër zjarrit.

Neni 34

Masat administrative dhe heqja e autorizimit

1. Policia e Shtetit, Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe e Shpëtimit dhe institucionet e tjera të specializuara shtetërore, të parashikuara me ligj,



për qëllimet e përcaktuara në këtë rregullore kanë të drejtë të kryejnë kontrolle dhe verifikime, rast pas rasti, në depot e magazinimit, të lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve, dyqanet e shitjeve, si dhe gjatë përdorimit të lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve.

2. Strukturat e Policisë së Shtetit vendosin marrjen e masave administrative, me pezullim, gjobë apo heqjen e autorizimit në rastet, kur:

a) Gjatë verifikimeve dhe kontrolleve të ushtruara, nëse vërejnë se pas pajisjes me autorizim:

- Personi juridik apo fizik përgjatë ushtrimit të veprimtarisë, humbet ose ndryshon kushtet dhe kriteret e përcaktuara për dhënien e autorizimit, kur nuk përbën vepër penale vendos pezullimin e autorizimit deri në përmirësimin e kushteve;

b) Ndëshkohet me gjobë kur gjatë transportit konstatohen shkelje të pikave 7 dhe 8, të nenit 166 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

c) Autorizimi hiqet në rastet kur:

- gjatë verifikimeve dhe kontrolleve të ushtruara, vërehen përsëritje të pajustifikuara të shkeljeve, të përcaktuara në shkronjën “a”;

- subjekti kryen vepër penale, që lidhet me ushtrimin e veprimtarisë për magazinimin, transferimin dhe asgjësimin e lëndëve plasëse, për përdorim civil, dhe lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve apo që cenojnë jetën dhe shëndetin e njeriut;

- Subjekti, gjatë ushtrimit të veprimtarisë për magazinimin e lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve, rrezikon jetën e njerëzve, kafshëve dhe të mjedisit.

3. Personat e interesuar mund të ankohen kundër vendimeve të strukturave të Policisë së Shtetit, në përputhje me ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Neni 35

E drejta e ankimit

1. Personi fizik apo juridik mund të ankohet në drejtorinë e policisë vendore, kundër vendimit të komisariatit të policisë për mosmiratim apo heqje të autorizimit për magazinim të lëndëve piroteknike fishekzjarrëve brenda 10 ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

2. Personi fizik apo juridik kundër vendimit të

drejtorisë së policisë vendore mund të ankohet në Gjykatën Administrative në përputhje me procedurën dhe afatet që përcaktohen në dispozitat e ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Neni 36

Dispozita të fundit

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr. 221, datë 7.5.2015

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË DEMOKRATIKE NË QARKUN ELBASAN, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 7.5.2015, me pjesëmarrjen e:

Lefterije	Luzi	kryetare
Denar	Biba	zëvendëskryetar
Edlira	Jorgaqi	anëtar
Gëzim	Veleshnja	anëtar
Hysen	Osmanaj	anëtar
Klement	Zguri	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Demokratike, në qarkun Elbasan, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të z. Ardjan Turku.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 175, pika 2, neni 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, të z. Ardjan Turku, deputet i zonës zgjedhore, qarku Elbasan,



KQZ-ja, në zbatim të nenit 164, të Kodit Zgjedhor, merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike, në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 36, datë 2.8.2013, ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore, qarku Elbasan, në zgjedhjet për Kuvendin, të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Demokratike, për zonën zgjedhore, qarku Elbasan, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 qershor 2013, ka fituar 4 mandate.

Sipas vendimit të mësipërm, lista shumemërore e Partisë Demokratike për qarkun Elbasan, e miratuar nga KQZ-ja, kandidati me numër rendor 4 është z. Luçiano Boçi.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Demokratike në qarkun e Elbasanit, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor dhe, konkretisht, nuk plotëson kriterin e gjinisë, duke mos pasur një në tre emrat e parë kandidatë nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 340, datë 11.5.2013, vendosi sanksionin administrativ gjobë, në masën 4 milionë lekë ndaj Partisë Demokratike. Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e PD-së, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, duhet të zbatonte dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, me vendimin nr. 340, datë 11.5.2013, “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Demokratike, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Punësim, Mirëqenie dhe Integritet”, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Demokratike për 12 zonat zgjedhore, së bashku me deklaratat model 03, për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore për çdo zonë zgjedhore.

Sipas nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, vakanca do të plotësohet nga kandidatja e parë në listë që i përket gjinisë femërore. Sipas deklaratës model 03 “Deklarim për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore” të

depozituar nga PD-ja në dokumentacionin e listës shumemërore të zonës zgjedhore, qarku Elbasan, rezulton se kandidatja e parë në listë sipas deklaramit është kandidatja me nr. rendor 6 (gjashtë) znj. Arbjola Fadil Halimi.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidates me numër rendor 6 (gjashtë) znj. Arbjola Fadil Halimi, të listës së Partisë Demokratike në Zonën Zgjedhore, qarku Elbasan.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, nenin 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Elbasan, znj. Arbjola Fadil Halimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

VENDIM

Nr. 222, datë 7.5.2015

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE NË QARKUN DURRËS, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 7.5.2015, me pjesëmarrjen e:

Lefterije	Luzi	kryetare
Denar	Biba	zëvendëskryetar
Edlira	Jorgaqi	anëtare
Gëzim	Veleshnja	anëtar
Hysen	Osmanaj	anëtar
Klement	Zguri	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare,



shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste, në qarkun e Durrësit, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të z. Artur Bushi.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 175, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Artur Bushi, deputet i zonës zgjedhore, qarku Durrës, KQZ-ja, në zbatim të nenit 164 të Kodit Zgjedhor merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 27, datë 2.8.2013, ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore, qarku Durrës, në zgjedhjet për Kuvendin, të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Socialiste për zonën zgjedhore, qarku Durrës, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 qershor 2013, ka fituar 6 mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste për qarkun e Durrësit, janë si më poshtë: me numër rendor 1 (një) Blendi Pëllumb Klosi, me nr. rendor 2 (dy) Klodjana Fatmir Spahiu, me nr. rendor 3 (tre) Ilir Hamit Beqja, me numër rendor 4 (katër) Namik Hamza Dokle, me nr. rendor 5 (pesë) Gentian Kastriot Bejko dhe me nr. rendor 6 (gjashtë) Artur Xhek Bushi.

KQZ-ja, me vendimin nr. 850, datë 26.12.2013, i ka dhënë mandatin e deputetes znj. Esmeralda Shkja, si pasojë e zëvendësimit të mandatit të z. Ilir Beqaj.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste në qarkun e Durrësit, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit

Zgjedhor dhe, konkretisht, nuk plotëson kriterin e gjinisë, duke mos pasur 30% kandidatë nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 340, datë 11.5.2013, vendosi sanksionin administrativ gjorbë, në masën 4 milionë lekë ndaj Partisë Socialiste. Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja në rast vakance, të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e PS-së, në zonën zgjedhore, qarku Durrës, duhet të zbatojë dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, me vendimin nr. 340, datë 11.5.2013, “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Socialiste, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane” për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Socialiste për 12 zonat zgjedhore, së bashku me deklaratat model 03, për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore për çdo zonë zgjedhore.

Sipas deklaratës model 03, rezulton se gjinia femërore, si gjinia më pak e përfaqësuar në listën shumemërore, qarku Durrës, ka shteruar. Në mbështetje të nenit 164, pika 2 (fjalë e fundit), duke qenë se lista e gjinisë femërore ka shteruar, KQZ-ja nuk mund të zbatojë sanksionin plotësues.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë duhet t’i kalojë kandidatit vijues të listës shumemërore të Partisë Socialiste, të zonës zgjedhore, qarku Durrës.

Sipas listës shumemërore të Partisë Socialiste për qarkun Durrës, kandidati vijues është kandidati, i cili renditet me numër rendor 7 (shtatë) z. Shkëlqim Besim Troplini. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm rezulton se personit, të cilit do t’i kalojë mandati si deputet për në Kuvendin e Shqipërisë nga lista shumemërore për të plotësuar vendin vakant, të krijuar nga dorëheqja e z. Artur Bushi dhe shterimit të kandidatëve të gjinisë femërore, është z. Shkëlqim Besim Troplini.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 175, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,



VENDOSI:

T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste, qarku Durrës, z. Shkëlqim Besim Troplini.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

VENDIM

Nr. 223, datë 7.5.2015

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË
DEPUTETIT TË KUVENDIT,
KANDIDATIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË PARTISË
DEMOKRATIKE NË QARKUN KUKËS,
PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË
NJOFTUAR NGA KUVENDI I
SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 7.5.2015, me pjesëmarrjen e:

Lefterije	Luzi	kryetare
Denar	Biba	zëvendëskryetar
Edlira	Jorgaqi	anëtare
Gëzim	Veleshnja	anëtar
Hysen	Osmanaj	anëtar
Klement	Zguri	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatis të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, në qarkun Kukës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të z. Besnik Dushaj.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 175, pika 2, neni 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Besnik

Dushaj, deputet i zonës zgjedhore, qarku Kukës, KQZ-ja, në zbatim të nenit 164, të Kodit Zgjedhor, merr vendim për dhënien e mandatis kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 36, datë 2.8.2013, ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore, qarku Kukës, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Demokratike për zonën zgjedhore, qarku Kukës, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 qershor 2013, ka fituar 3 mandate.

Sipas vendimit të mësipërm, lista shumemërore e Partisë Demokratike për qarkun Kukës, e miratuar nga KQZ-ja, kandidati me numër rendor 3 është z. Alban Zeneli.

Rezulton se lista shumemërore e partisë Demokratike në qarkun e Kukësit, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor dhe, konkretisht, nuk plotëson kriterin e gjinisë, duke mos pasur një në tre emrat e parë kandidatë nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 340, datë 11.5.2013, vendosi sanksionin administrativ gjorbë, në masën 4 milionë lekë ndaj Partisë Demokratike. Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e PD-së, në zonën zgjedhore, qarku Kukës, duhet të zbatonte dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, me vendimin nr. 340, datë 11.5.2013 “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Demokratike, pjesëtare e Koalicionit “Aleanca për Punësim, Mirëqenie dhe Integritim”, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Demokratike për 12 zonat zgjedhore, së bashku me deklaratat model 03, për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore për çdo zonë zgjedhore.

Sipas nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, vakanca do të plotësohet nga kandidata e parë në listë që i përket gjinisë femërore. Sipas deklaratës model 03 “Deklarim për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore”, të



depozituar nga PD-ja në dokumentacionin e listës shumemërore të zonës zgjedhore, qarku Kukës, rezulton se kandidatja e parë në listë sipas deklaramit është kandidatja me nr. rendor 5 (pesë) znj. Mimoza Man Hajdarmataj.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidates me numër rendor 5 (pesë), znj. Mimoza Man Hajdarmataj, të listës së Partisë Demokratike në zonën zgjedhore, qarku Kukës.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, nenin 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Kukës, znj. Mimoza Man Hajdarmataj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

VENDIM

Nr. 224, datë 7.5.2015

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË DEMOKRATIKE NË QARKUN TIRANË, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 7.5.2015, me pjesëmarrjen e:

Lefterije	Luzi	kryetare
Denar	Biba	zëvendëskryetar
Edlira	Jorgaqi	anëtare
Gëzim	Veleshnja	anëtar
Hysen	Osmanaj	anëtar
Klement	Zguri	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, në qarkun Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të z. Halim Kosova.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 175, pika 2, neni 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Halim Kosova, deputet i zonës zgjedhore, qarku Tiranë, KQZ-ja, në zbatim të nenit 164 të Kodit Zgjedhor, merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 36, datë 2.8.2013, ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore, qarku Tiranë, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Demokratike, për zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 qershor 2013, ka fituar 11 mandate.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Demokratike në qarkun Tiranë plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2. Gjithashtu, konstatojmë se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

KQZ-ja, me vendimin nr. 340, datë 11.5.2013, “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Demokratike, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Punësim, Mirëqenie dhe Integritim”, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Demokratike, për 12 zonat zgjedhore.



Sipas vendimit të mësipërm, lista shumemërore e Partisë Demokratike për qarkun Tiranë, e miratuar nga KQZ-ja, kandidati me numër rendor 11 është z. Kastriot Islami.

Sipas listës shumemërore të Partisë Demokratike për qarkun Tiranë, kandidati i cili renditet me numër rendor 12 (dymbëdhjetë) është z. Asllan Shaban Dogjani. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm rezulton se, personit të cilit do t'i kalojë mandati si deputet për në Kuvendin e Shqipërisë nga lista shumemërore për të plotësuar vendin vakant të krijuar, për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë z. Halim Kosova është z. Asllan Shaban Dogjani, i cili është kandidati vijues i radhës, i renditur përkatësisht me numër rendor 12 (dymbëdhjetë).

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, nenin 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Tiranë, z. Asllan Shaban Dogjani.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

VENDIM

Nr. 225, datë 7.5.2015

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE NË QARKUN FIER, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 7.5.2015, me pjesëmarrjen e:

Lefterije	Luzi	kryetare
Denar	Biba	zëvendëskryetar
Edlira	Jorgaqi	anëtar
Gëzim	Veleshnja	anëtar
Hysen	Osmanaj	anëtar
Klement	Zguri	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste, në qarkun Fier, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të znj. Majlinda Bufi.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, të znj. Majlinda Bufi, deputet i zonës zgjedhore, qarku Fier, KQZ-ja, në zbatim të nenit 164 të Kodit Zgjedhor merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 36, datë 2.8.2013, ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore, qarku Fier, në zgjedhjet për Kuvendin, të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Socialiste për zonën zgjedhore, qarku Fier, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 qershor 2013, ka fituar 9 mandate.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste në qarkun Fier, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2. Gjithashtu, konstatohet se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

KQZ-ja, me vendimin nr. 337, datë 11.5.2013,



“Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Socialiste, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane” për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Socialiste për 12 zonat zgjedhore.

Sipas vendimit të mësipërm, lista shumemërore e Partisë Socialiste për qarkun Fier, e miratuar nga KQZ-ja, kandidati me numër rendor 9, është z. Ervin Agim Koçia.

Sipas listës shumemërore të Partisë Socialiste për qarkun Fier, kandidati, i cili renditet me numër rendor 15 (pesëmbëdhjetë) është znj. Antoneta Nasi Dhima. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm rezulton se, personit të cilit do t'i kalojë mandati si deputet për në Kuvendin e Shqipërisë nga lista shumemërore për të plotësuar vendin vakant të krijuar, për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, znj. Majlinda Bufi, është znj. Antoneta Nasi Dhima, i cili është kandidati vijues i radhës, i renditur përkatësisht me numër rendor 15 (pesëmbëdhjetë).

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, nenin 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste, qarku Fier, znj. Antoneta Nasi Dhima.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

VENDIM

Nr. 226, datë 7.5.2015

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË DEMOKRATIKE NË QARKUN SHKODËR, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 7.5.2015, me pjesëmarrjen e:

Lefterije	Luzi	kryetare
Denar	Biba	zëvendëskryetar
Edlira	Jorgaqi	anëtar
Gëzim	Veleshnja	anëtar
Hysen	Osmanaj	anëtar
Klement	Zguri	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, në qarkun Shkodër, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të z. Ardjan Turku.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të znj. Voltana Ademi, deputet i zonës zgjedhore, qarku Shkodër, KQZ-ja, në zbatim të nenit 164 të Kodit Zgjedhor, merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike, në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 36, datë 2.8.2013, ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore, qarku Shkodër, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit



2013. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Demokratike për zonën zgjedhore, qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 qershor 2013, ka fituar 5 mandate.

Sipas vendimit të mësipërm, lista shumemërore e Partisë Demokratike për qarkun Shkodër, e miratuar nga KQZ-ja, kandidati me numër rendor 5, është z. Gjovalin Bzhetaj.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Demokratike në qarkun e Shkodrës, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, i plotëson kriteret ligjore, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2. Gjithashtu, konstatojmë se vakanca i përket një mandati të fituar sipas pikës 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor. Përpara krijimit të vakancës, mandati i perkiste kandidates znj. Voltana Ademi, e cila i përket gjinisë më pak të përfaqësuar, në këto kushte në plotësimin e vakancës, KQZ-ja do të zbatojë përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

KQZ-ja, me vendimin nr. 340, datë 11.5.2013, “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Socialiste, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Punësim, Mirëqenie dhe Integritet”, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Demokratike për 12 zonat zgjedhore, së bashku me deklaratat model 03, për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore për çdo zonë zgjedhore.

Sipas deklaratës model 03 “Deklarim për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore” të depozituar nga PD-ja në dokumentacionin e listës shumemërore të zonës zgjedhore, qarku Shkodër, kandidatja e radhës në listë pas znj. Voltana Ademi është kandidatja me nr. rendor 10 (dhjetë), znj. Irma Musa Kopliku (Alushi). Sipas nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, vakanca do të plotësohet nga kandidatja e parë në listë pas znj. Voltana Ademi, që i përket gjinisë femërore, është kandidatja me nr. rendor 10 (dhjetë), znj. Irma Musa Kopliku (Alushi).

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, nenin 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Shkodër, znj. Irma Musa Kopliku (Alushi).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

VENDIM

Nr. 227, datë 7.5.2015

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM NË QARKUN ELBASAN, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 7.5.2015, me pjesëmarrjen e:

Leferije	Luzi	kryetare
Denar	Biba	zëvendëskryetar
Edlira	Jorgaqi	anëtare
Gëzim	Veleshnja	anëtar
Hysen	Osmanaj	anëtar
Klement	Zguri	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënie e mandati të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integritet, në qarkun Elbasan, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të znj. Miranda Rira.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të znj. Miranda Rira,



deputet i zonës zgjedhore, qarku Elbasan, KQZ-ja, në zbatim të nenit 164 të Kodit Zgjedhor, merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 36, datë 2.8.2013, ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore, qarku Elbasan, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, për zonën zgjedhore, qarku Elbasan, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 qershor 2013, ka fituar 2 mandate.

Rezultoni se lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në qarkun Elbasan, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2. Gjithashtu, konstatojmë se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

KQZ-ja, me vendimin nr. 341, datë 11.5.2013, “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, pjesëtare e Koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane”, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Socialiste, për 12 zonat zgjedhore.

Sipas vendimit të mësipërm, lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për qarkun Elbasan, e miratuar nga KQZ-ja, kandidati me numër rendor 2 është znj. Miranda Rira, zëvendësohet po me të njëjtën gjini së cilës i përket nr. rendor 7 (shtatë), znj. Edlira Nuri Çekrezi.

Sipas listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për qarkun Elbasan kandidat, i cili renditet me numër rendor 7 (shtatë), është znj. Edlira Nuri Çekrezi. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm rezultoi se, personit të cilit do t'i kalojë mandati si deputet për në Kuvendin e Shqipërisë nga lista shumemërore për të plotësuar vendin vakant të krijuar, për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, znj. Miranda Rira është znj. Edlira Nuri Çekrezi, i cili është kandidati vijues i radhës, i renditur përkatësisht me numër rendor 7 (shtatë).

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, nenin 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Elbasan, znj. Edlira Nuri Çekrezi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

VENDIM

Nr. 228, datë 7.5.2015

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE NË QARKUN FIER, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 7.5.2015, me pjesëmarrjen e:

Lefteriye	Luzi	kryetare
Denar	Biba	zëvendëskryetar
Edlira	Jorgaqi	anëtare
Gëzim	Veleshnja	anëtar
Hysen	Osmanaj	anëtar
Klement	Zguri	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste, në qarkun Fier, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të z. Armando Subashi.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.



KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, të z. Armando Subashi, deputet i zonës zgjedhore, qarku Fier, KQZ-ja, në zbatim të nenit 164 të Kodit Zgjedhor, merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 36, datë 2.8.2013, ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues, për zonën zgjedhore, qarku Fier, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Socialiste, për zonën zgjedhore, qarku Fier, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 qershor 2013, ka fituar 9 mandate.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste në qarkun Fier, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2. Gjithashtu, konstatohet se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

KQZ-ja, me vendimin nr. 337, datë 11.5.2013, “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Socialiste, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane”, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Socialiste, për 12 zonat zgjedhore.

Sipas vendimit të mësipërm, lista shumemërore e Partisë Socialiste për qarkun Fier, e miratuar nga KQZ-ja, kandidati me numër rendor 10 është z. Anduel Xhindi.

Sipas listës shumemërore të Partisë Socialiste për qarkun Fier, kandidati i cili renditet me numër rendor 11 (njëmbëdhjetë) është z. Bujar Avdulla Çela. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm rezulton se, personit të cilit do t'i kalojë mandati si deputet për në Kuvendin e Shqipërisë nga lista shumemërore për të plotësuar vendin vakant të krijuar, për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë,

z. Armando Subashi është z. Bujar Çelaj, i cili është kandidati vijues i radhës, i renditur përkatësisht me numër rendor 11 (dymbëdhjetë).

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, nenin 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste, qarku Fier, z. Bujar Avdulla Çela.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KËRKESË

Nr. 96/194, datë 15.5.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Energjisë dhe Industrisë shpall kërkesën për shpronësim me interes publik, të pasurive të paluajtshme të tipit “tokë bujqësore arë”, që preken nga ndërtimi i “HEC Ashta Shkodër”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është “Energji Ashta” sh.p.k., Tiranë.

Me anë të këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e kompensimit përkatës, të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, për secilin pronar sipas listës emërore të mëposhtme.

Brenda 15 ditëve nga data e fundit të publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë pranë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit.

**MINISTRI I ENERGJISË DHE
INDUSTRIË
Damian Gjikhuri**



Shtojca e listës së shpronësimeve sipas VKM Nr. 522, datë 30.6.2010 Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga shpronësimi për qëllim të ndërtimit, pronësisë, shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe transferimit në favor të Shtetit të projektit të një hidrocentrali të ri në Ashtë, në Qarkun e Shkodrës

TABELA PËRMBLEDHËSE PËR QARKUN SHKODËR

nr	Objekti	Njesia e Qeverisjes Vendore	Shpronësim Definitiv							Të mbjellat			Vlera totale e kompensimit	Shënime
			Zona Kadastrale	Adresa	Lloji i pronës	Sipërfaqja e pronës (m2)	Sipërfaqja e shpronësimit (m2)	Çmimi Lekë/m2	Vlera e Kompensimit	Sipërfaqja	Lloji i të mbjellave	Vlera e të mbjellave		
1	HEC Ashta	Komuna Bushat	2236	Kosmaç	Pyll	10.000	10.000	402	4.020.000	0	-	0	4.020.000	
		Bashkia Vau i Dejës	1466	Dejë	Arë	5.250	3.548	399	1.415.612	0	-	0	1.415.612	
					Pemëtore	5.290	2.784	399	1.110.812	0	-	0	1.110.812	
					Truall	5.752	1.152	399	459.604	0	-	0	459.604	
			3498	Spatharë	Arë	1.690	442	399	176.494	0	-	0	176.494	
					Pemëtore	1.730	1.154	399	460.446	-	Hardhi Pemë frutore	817.000	1.277.446	
					Truall	200	155	399	61.845	0	-	0	61.845	
			2702	Mjedë	Arë	17.460	16.200	418	6.771.763	0	-	0	6.771.763	
							35.436		14.476.576			817.000	15.293.576	

Vlera totale e kompensimit 15.293.576 Lekë



Shtojca e listës së shpronësimeve sipas VKM Nr. 522, datë 30.6.2010 Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga shpronësimi për qëllim të ndërtimit, pronësisë, shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe transferimit në favor të Shtetit të projektit të një hidrocentrali të ri në Ashtë, në Qarkun e Shkodrës

Qarku Shkodër

Bashkia Vau i Dejës

Lloji i pasurisë që shpronësohet: Arë, Truall, Pemëtore

Lloji i pasurisë që dëmtohet për shkak të ndërtimit: Hardhi, Pemë frutore

Nr	Objekti	Shpronësim Definitiv										Shpronësim provizor				Vlera totale e kompensimit	Adresa e pronarit	Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i Pasurisë	Z.K	Nr. Pasurisë	Sip. e Pasurisë (m²)	Sip. shpronësim definitiv (m2)	Çmimi lekë/m²	Vlera e kompensimit (Lekë)	Lloji i kulturës	Sasia rrënjë	Vlera Lekë/rrënjë	Vlera e kompensimit (lekë)			
1	HEC Ashta	Cesk	Gasper	Deja	Pemëtore	1466	50/7	590,00	50,00	399	19.950,00	-	-	-	0	19.950,00	Dejë	
2	HEC Ashta	Cesk	Gasper	Deja	Pemëtore	1466	52/15	1.500,00	925,95	399	369.454,05	-	-	-	0	369.454,05	Dejë	
3	HEC Ashta	Ejell	Ndrek	Deja	Arë	1466	52/6	3.300,00	2.119,93	399	845.852,07	-	-	-	0	845.852,07	Dejë	
4	HEC Ashta	Gjon	Zef	Deja	Arë	1466	52/40	450,00	387,30	399	154.532,70	-	-	-	0	154.532,70	Dejë	
6	HEC Ashta	Lek	Zef	Deja	Arë	1466	52/42	1.000,00	589,63	399	235.262,37	-	-	-	0	235.262,37	Dejë	
8	HEC Ashta	Ludovik	Gasper	Deja	Pemëtore	1466	52/14	2.100,00	980,25	399	391.119,75	-	-	-	0	391.119,75	Dejë	
10	HEC Ashta	Martin	Gjergj	Deja	Arë	1466	52/17	500,00	451,04	399	179.964,96	-	-	-	0	179.964,96	Dejë	
11	HEC Ashta	Petrit	Muhamet	Behari	Pemëtore	1466	47/10	1.100,00	827,79	399	330.288,21	-	-	-	0	330.288,21	Dejë	



12	HEC Ashta	Zaim	Shaqir	Hoxhaj	Pemëtore Truall	1466	47/17	5.752,00	1.151,89	399	459.604,11	-	-	-	0	459.604,11	Dejë	
13	HEC Ashta	Sanije	Hysen	Bujari	Arë	2702	81/2	17.460,00	16.200,39	418	6.771.763,02	-	-	-	0	6.771.763,02	Mjedë	
16	HEC Ashta	Gege	Ndoc	Ndoci	Arë	3498	129/2	1.690,00	442,34	399	176.493,66	Hardhi	400	400	160.000,00	489.493,66	Spatharë	
												Pemë frutore	51	3000	153.000,00			
17	HEC Ashta	Mark	Ndoc	Ndoci	Pemëtore	3498	109/4	750,00	734,00	399	292.866,00	Hardhi	300	400	120.000,00	463.866,00	Spatharë	
												Pemë frutore	17	3000	51.000,00			
18	HEC Ashta	Gac	Lazer	Caka	Pemëtore Truall	3498	105/7	560,00	155,00	399	61.845,00	Hardhi	300	400	120.000,00	247.845,00	Spatharë	
												Pemë frutore	22	3000	66.000,00			
21	HEC Ashta	Jak	Lazer	Caka	Pemëtore	3498	131/1	420,00	420,00	399	167.580,00	Hardhi	285	400	114.000,00	314.580,00	Spatharë	
												Pemë frutore	11	3000	33.000,00			
Shuma në m2									25.436	Shuma në Lekë						11.273.576		



Shtojca e listës së shpronësimeve sipas VKM Nr. 522, datë 30.6.2010 Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga shpronësimi për qëllim të ndërtimit, pronësisë, shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe transferimit në favor të Shtetit të projektit të një hidrocentrali të ri në Ashtë, në Qarkun e Shkodrës

Qarku Shkodër

Komuna Bushat

Lloji i pasurisë që shpronësohet: Pyll

Lloji i pasurisë që dëmtohet për shkak të ndërtimit: s'ka

Nr	Objekti	Shpronësim Definitiv									Shpronësim provizor				Vlera totale e kompensimit	Adresa e pronarit	Shënime	
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i Pasurisë	Z.K	Nr. Pasurisë	Sip. e Pasurisë (m²)	Sip. shpronësim definitiv (m2)	Çmimi lekë/m²	Vlera e kompensimit (Lekë)	Lloji i kulturës	Sasia rrënjë	Vlera Lekë/rrënjë				Vlera e kompensimit (lekë)
1	Ashta HPP	Hajdar	Tahir	Maldi	Pyll	2236	832/1	10.000,00	10.000,00	402	4.020.000,00	-	-	-	0	4.020.000,00	Kosmaç	
		Nasuf	Tahir	Maldi														
		Anila	Fejzi	Maldi														
		Arjola	Fejzi	Kalej (Maldi)														
		Emrah	Fejzi	Maldi														
		Nadire	Tahir	Idrizi (Maldi)														
		Fetnete	Tahir	Sulejmani (Maldi)														
Shuma në m2								10.000	Shuma në Lekë						4.020.000			

Adresa e pronarit është shënuar vetëm si Fshat, pasi nuk egzistojnë adresa të sakta rrugësh.

Energji Ashta



**VENDIM**

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3151, datë 17.4.2015, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Viktor Sharko, i biri i Thodhorit dhe i Uranisë, lindur më 3.1.1932, në Çeravë, Përmet dhe banues në Tiranë, si dhe caktimin në cilësinë e kujdestares për administrimin e pasurisë së personit të zhdukur, vajzën e tij, Evis Shkëmbi (Sharko).

KËRKESË

Shtetasja Sofika Qako, e bija e Vasilit, e datëlindjes 14.7.1957, e lindur dhe banuese në Berat, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, shpalljen të zhdukur të të birit, shtetasit Klodian Perikli Londo.

KËRKUESE
Sofika Qako

KËRKESË

Shtetasi Sabri Hasanaj kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, shpalljen të zhdukur të djalit të tij, shtetasit Saimir Hasanaj, i datëlindjes 1.6.1978, lindur në Zallë Reç dhe banues në Peshkopi, si dhe caktimin si kujdestar të pasurisë së tij.

KËRKUES
Sabri Hasanaj

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 308 lekë